Усовршување и примена на проактивни методи во откривањето и идентификацијата на потенцијални и ЖТЛ, со посебен осврт на деца ЖТЛ	Ефикасна примена на индикаторите за идентификација на ЖТЛ и СОП за постапување со ЖТЛ	90. Подготвување и имплементирање програма за обуки за ефикасна примена на индикаторите за идентификација на ЖТЛ и СОП за постапување со ЖТЛ согласно со НС и НАП 2017-2020		1. МВР 2. МТСП-НМУ	2017	Подготвена програма/број на спроведените обуки и обучените лица	1. МВР 2. МТСП-НМУ/МО
		91. Примена на проактивни методи базирани на криминалистичко разузнавање во откривањето и идентификацијата на ЖТЛ		МВР/ОСОСК/ЕТЛКМ	Континуирано 2017-2020	Број на откриените случаи на ТЛ и идентификуваните ЖТЛ	МВР/ОСОСК/ЕТЛКМ
		92. Обука на ПС на МВР на локално/централно/регионално ниво за примена на проактивни методи за откривање и идентификација на ЖТЛ		1. МВР- 2. МО	2017-2020	Број на спроведените обуки и обучените лица	1. МВР 2. МО/ТАИЕХ
		93. Меѓусекторска обука на ПС на МВР на локално/централно/регионално ниво за примена на индикаторите за идентификација на ЖТЛ, СОП за постапување со НДС и РКЛС		1. МТСП-НМУ 2. МВР/ЗГ/МО	2017-2020	Број на спроведените обуки и обучените лица	1. МВР 2. МТСП-НМУ/МО/ТАИЕХ
		94. Обука на мрежа на социјални работници за примена на проактивни методи за идентификација на потенцијални и ЖТЛ		1. МТСП-НМУ 2. МВР/ЗГ/МО	2017-2020	Број на спроведените обуки и обучените лица	1. МТСП-НМУ 2. МВР/ЗГ/МО
Активно вклучување на повеќе владини институции/агенции и ЗГ во откривањето и идентификацијата на ЖТЛ	Проширен е бројот на владините институции/агенции и ЗГ во откривањето и идентификацијата на ЖТЛ	95. Обука на трудови инспектори од ДИТ за ТЛ со цел трудова експлоатација и примена на индикаторите за идентификација на ЖТЛ и СОП за постапување со ЖТЛ		1. МТСП-НМУ 2. ЗГ/МО	2017-2020	Број на спроведените обуки и обучените лица	1. МТСП-НМУ 2. ЗГ/МО
		96. Обука на припадниците на Сојузот на синдикати и Стопанска комора на РМ за ТЛ, а особено за откривање и идентификација на трудова експлоатација и упатување на ЖТЛ		1. МТСП-НМУ 2. ЗГ/Сојуз на синдикати и стопански комори	2017-2020	Број на спроведените обуки и обучените лица	1. МТСП-НМУ 2. ЗГ/ Сојуз на синдикати и стопански комори
		97. Обука на ЗГ за примена на индикаторите за идентификација на ЖТЛ и СОП за постапување со ЖТЛ		1. ЗГ/МО 2. МТСП-НМУ/МВР	2017-2020	Број на спроведените обуки и обучените лица	1. ЗГ/МО 2. МТСП-НМУ/МВР



СТРАТЕГИСКА ЦЕЛ	ОЧЕКУВАН РЕЗУЛТАТ	АКТИВНОСТИ		1. Надлежна институција, МО/ЗГ- носител на активност	ВРЕМЕНСКА РАМКА	ИНДИКАТОР	БУЏЕТ/ НОСИТЕЛ НА БУЏЕТОТ
				2. Институција, МО/ЗГ-учесник на активност			
Проактивен пристап во откривањето на потенцијални и ЖТЛ помеѓу ранливите категории мигранти/бегалци, а особено на НДС	Идентификувани се ранливите категории странци помеѓу мигрантите/бегалците, а особено НДС, и спроведено е нивно профилирање со цел идентификација на потенцијални и ЖТЛ	98. Меѓуресорска обука за примена на индикаторите за идентификација на потенцијални и ЖТЛ помеѓу мигрантите/бегалците, а особено меѓу НДС		1. МВР 2. МТСП-НМУ/ЗГ/МО	2017 - 2018	Број на спроведените обуки и обучените лица	1. МВР 2. МТСП-НМУ/ЗГ/МО
		99. Меѓуресорска обука за примена на СОП за постапување со НДС		1. МВР 2. МТСП-НМУ/ЗГ/МО	2017 - 2018	Број на спроведените обуки и обучените лица	1. МВР 2. МТСП-НМУ/ЗГ/МО
		100. Обука на ПС од СГР/РЦ за ГР, за примена на СОП за постапување со РКЛС		МВР	2017 - 2018	Број на спроведените обуки и обучените лица	МВР/МО
Зголемување на капацитетите на вработените во МНР/ДКП во делот на идентификација на потенцијални ЖТЛ при аплицирање за виза за влез во РМ	Вработените во МНР што се упатуваат на работа во ДКП на РМ во странство да се обучат за идентификација на потенцијални ЖТЛ помеѓу барателите на виза	101. Обука за вработените во МНР што се упатени на работа во ДКП на РМ во странство со цел ефикасна идентификација на потенцијални и ЖТЛ со примена на индикаторите за идентификација на ЖТЛ		1. МНР 2. НК/МВР	2017-2020	Број на спроведените обуки и обучените лица	1. МНР 2. НК/МВР


СТРАТЕГИСКА ЦЕЛ	ОЧЕКУВАН РЕЗУЛТАТ	АКТИВНОСТИ		1. Надлежна институција, МО/ЗГ- носител на активност	ВРЕМЕНСКА РАМКА	ИНДИКАТОР	БУЏЕТ/ НОСИТЕЛ НА БУЏЕТОТ
				2. Институција, МО/ЗГ- учесник на активност			

#### 4. ДИРЕКТНА ПОМОШ, ЗАШТИТА, ИНТЕГРАЦИЈА И ДОБРОВОЛНО ВРАЌАЊЕ НА ЖТЛ/МИГРАНТИ

Обезбедување заштита и помош на ЖТЛ и илегални мигранти во согласност со меѓународните стандарди	Обезбедено безбедно место за сместување и дадена првична помош на ЖТЛ и мигранти согласно со меѓународните стандарди	102. Наоѓање решение за сместување на ЖТЛ од машки пол		МТСП-НМУ	2017 - 2018	Техничко решение за обезбедени услови	МТСП-НМУ
		103. Подобрување на просторните капацитети на ПЦС со кои ќе се обезбедат посебни простории за сместување НДС и мајки со деца, издвоени од возрасните		1. МВР	2017 - 2018	Техничко решение за обезбедени услови	1. МВР 2. МО
		104. Зголемување на бројот на згрижувачките семејства за сместување/ згрижување потенцијални и ЖТЛ/деца		МТСП-НМУ	2017 - 2018	Број на згрижувачките семејства и број на згрижените/ сместените ЖТЛ и ранливата категорија мигранти	МТСП-НМУ
		105. Избор и обука на згрижувачки семејства за згрижувањето деца-жртви, деца-потенцијални жртви и ранливи категории мигранти		1. МТСП-НМУ 2. ЗГ/МО	2017 - 2018 Континуирано	Број на селектираните згрижувачки семејства - Број на спроведените обуки на згрижувачки семејства	1. МТСП-НМУ 2. ЗГ/МО
	Зајакнати капацитети на стручните кадри во ЦЛЖТЛ и Прифатниот центар за странци	106. Подготвување наставни програми-модули за обука на персоналот вклучен во ЦЛЖТЛ и за ПЦС		1. МТСП-НМУ/МВР 2. ЗГ/МО	2017-2018	Подготвени програми-модули	1. МТСП-НМУ/МВР 2. ЗГ/МО
		107. Организирање обуки за персоналот во ЦЛЖТЛ и Прифатниот центар за странци заедно со припадниците на ЗГ вклучени во нив		1. МТСП-НМУ/МВР 2. ЗГ/МО	2017-2020	Број на обуки и обучени лица	1. МТСП-НМУ 2. ЗГ/МО
		108. Организирање обука на старатели за деца ЖТЛ, НДС и деца-мигранти		1. МТСП-НМУ 2. ЗГ/МО	2017-2020	Број на обуките и обучените лица	1. МТСП-НМУ 2. ЗГ/МО
		109. Подготвување информативен материјал за правата на ЖТЛ, ранливите категории мигранти, на повеќе јазици, и негово дистрибуирање веднаш по самото сместување во ЦЛЖТЛ/ПЦС		1. МВР/МТСП-НМУ 2. ЗГ/МО	Континуирано 2017-2020	Број на подготвениот и поделениот информативен материјал	1. МВР/МТСП-НМУ 2. ЗГ/МО
	Потенцијалните и ЖТЛ, ранливите категории мигранти и другите категории мигранти се информирани за нивните права и обврски и им се обезбедени правна помош и поддршка	110. Овозможување правна помош и поддршка од страна на правен застапник во постапките за одобрување привремен престој/барање за азил, и застапување на ЖТЛ во кривична постапка во својство на сведок/оштетен и во постапка за надомест на нематеријална штета		1. МП 2. ЗГ	2017 - 2018	Број на случаите во кои е обезбедена правна помош	1. МП 2. ЗГ
		111. Подготвување ростер/листа и избор и селекција на адвокати на правни застапници на ЖТЛ во кривична и граѓанска постапка		1. НК 2. ЗГ/Адвокатска комора на РМ	2017	Број на селектираните адвокати/правни застапници	1. НК 2. ЗГ/Адвокатска комора на РМ
		112. Иницијатива до Адвокатската комора на РМ, за селекција на адвокати за ростерот, кои про боно во судска постапка ќе застапуваат ЖТЛ и ранливи категории мигранти		НК	2017-2020	Доставена иницијатива	Нема
		113. Обука на избраните адвокати за бесплатна правна помош и застапување ЖТЛ и ранливи категории странци		1. ЗГ/МО 2. МВР/МТСП	2017-2020	Број на спроведените обуки и обучените адвокати	1. ЗГ/МО 2. МВР/МТСП

СТРАТЕГИСКА ЦЕЛ	ОЧЕКУВАН РЕЗУЛТАТ	АКТИВНОСТИ		1. Надлежна институција, МО/ЗГ- носител на активност	ВРЕМЕНСКА РАМКА	ИНДИКАТОР	БУЏЕТ/ НОСИТЕЛ НА БУЏЕТОТ
				2. Институција, МО/ЗГ- учесник на активност			
Интегрирање во социјалната средина на ЖТЛ/ранливите категории мигранти/ баратели на азил на кои им е одобрен привремен престој во РМ	Континуирано спроведени програми за помош, поддршка и реинтеграција на ЖТЛ/мигранти/баратели на азил	114. Буџетска алокација за спроведувањето на програмите за ресоцијализација и реинтеграција		МТСП	2017 - 2020	Висина на определениот буџет	МТСП
		115. Обезбедување стандарден пакет на услуги за основните потреби, правна, медицинска помош, психосоцијална помош и вклучување на ЖТЛ/мигранти во образовниот процес		1. МТСП/МОН 2. ЗГ/МО/Црвен крст	2017 - 2020	Листа на обезбедените услуги	1. МТСП/МОН 2. ЗГ/МО/Црвен крст
<b>5. ЕФИКАСНО ОТКРИВАЊЕ И ГОНЕЊЕ НА СТОРИТЕЛИТЕ НА КРИВИЧНО ДЕЛО ТЛ И КМ</b>							
Формирање национална работна група (Task force) за работа на случаи на ТЛ	Формирана е национална работна група (Task force) за работа на случаи на ТЛ	116. НК доставува информација до министерот, директорот на БЈБ и ОЈО за гонење организиран криминал и корупција за оваа специфична цел заради добивање согласност за формирање работна група (Task force)		НК	2017	Доставена информација	Нема
		117. Донесување одлука за формирање работна група за работа на случаи на ТЛ		1. МВР/БЈБ 2. ОЈО	2017	Одлука за формирање работна група,	Нема
		118. Формирање работна група со претставници од МВР/ОКП/ОСОСК-ЕТЛКМ/СВР/РЦ за ГР//ЦПС/ОПЕ и ОЈО		1. МВР/БЈБ 2. ОЈО	2017	Именувани претставници на работен тим	Нема
		119. Подготвување протокол за работа на работна група		1. МВР/БЈБ 2. ОЈО	2017	Подготвен протокол	Нема
Спроведување проактивни криминалистички истраги против сите инволвирани лица- сторители на КД на ТЛ, истовремено и спроведување финансиски истраги за утврдување на криминалната добивка од КД	Успешно планирани и ефикасно спроведени проактивни криминалистички истраги за ТЛ	120. Профилирање криминални групи и поединци што на територијата на РМ планираат и вршат КД ТЛ и КМ, со посебен осврт на регрутирање преку интернет со цел трудова и сексуална експлоатација		МВР/ОСОСК/ЕТЛКМ	2017-2020 континуирано	Број на профилираните криминални групи и поединци	МВР
		121. Спроведување проактивни криминалистички истраги со финансиски истраги против сторителите со примена на ПИМ, со посебен аспект на меѓусекторски/меѓуресорски заеднички истраги		1. МВР/ОКП/ОСОСК/ ЕТЛКМ 2. ОЈО/УФР	2017-2020 континуирано	Број на спроведените истраги, пријавените лица, утврдената криминална добивка и идентификуваните ЖТЛ	1. МВР/ОКП/ОСОСК/ ЕТЛКМ 2. ОЈО/ УФР
		122. Формирање ЗИТ со странски полициски служби за спроведување меѓународни истраги за ТЛ		1. ОЈО 2. МВР/ЕВРОЦ АСТ/ЕВРОПОЛ	2017-2020	Број на формираните ЗИТ	1. ОЈО 2. МВР/ЕВРОЦ АСТ/ЕВРОПОЛ
		123. Спроведување напредни обуки на припадници на ЕТЛКМ/РЦ за ГР/СВР на следните теми: - напредни техники за водење истраги за ТЛ - финансиски истраги против сторителите - новите форми на ТЛ, особено трговијата со деца - интернет-регрутација на ЖТЛ		1. МВР 2. МО	2017-2020	Спроведени се по две обуки годишно на вкупно 50 припадници на МВР	1. МВР 2. МО/ТАИЕХ

СТРАТЕГИСКА ЦЕЛ	ОЧЕКУВАН РЕЗУЛТАТ	АКТИВНОСТИ		1. Надлежна институција, МО/ЗГ- носител на активност	ВРЕМЕНСКА РАМКА	ИНДИКАТОР	БУЏЕТ/НОСИТЕЛ НА БУЏЕТОТ
				2. Институција, МО/ЗГ-учесник на активност			
Зголемување на прекуграничната полициска соработка во областа на ТЛ и КМ	Соработката е зајакната, разменети се информации и спроведени се заеднички истраги за ТЛ и КМ	124. Размена на информации со земјите од регионот во врска со идентификувањето и профилирањето на ОКГ што вршат КД,ТЛ и КМ		1. МВР//СМПС 2. СЕЛЕК/ЕВРОПОЛ	Континуирано 2017-2020	- Број на одржаните работни средби - Број на разменетите информации - Број на спроведените заеднички истраги	Нема
Зајакнување на капацитетите на ЈО и судовите во водењето на кривична постапка со цел ефикасно гонење на сторителите на ТЛ	Јавните обвинители и судиите се обучени за сите форми на ТЛ, начин на извршување на делото и одземање на имотната корист	125. Доставување предлог-листа на теми за ТЛ што би биле вклучени во Годишната програма за обуки на Академија за судии и јавни обвинители на РМ		1. НК 2. АСЈО	2017-2020	Доставена предлог-листа на теми за ТЛ	1. АСЈО на РМ 2. МО
		126. Обука на ЈО од ОЈО за гонење за кривични дела од организиран криминал и корупција при Основниот суд Скопје 1 на следните теми: - трендовите на ТЛ, - формите на ТЛ - начинот на извршување, - одземањето на криминалната добивка од КД ТЛ - примената на начелото за неказнување на ЖТЛ		1. АСЈО 2. МО	По 2 обуки годишно на вкупно 50 припадници од ЈО/ОС/МВР/Финансиска Полиција  2017-2020	Број на спроведените обуки обучените професионалци	1. АСЈО 2. МО
Заштита на правата на ранливите категории сведоци/жртвите во кривична постапка согласно со чл. 54 и 55 од ЗКП	Во Кривичната постапка на ранливите категории сведоци/ЖТЛи на ТЛ им се обезбедени правата согласно со одредбите од чл. 54 и 55 од ЗКП	127. Обука на јавни обвинители и судии за доследна примена на одредбите од членовите 54 и 55 од ЗКП		1. АСЈО 2. ЈО/СУД/Правен застапник	Континуирано 2017-2020	Број на случаите и ЖТЛ на кои во кривична постапка се применети одредбите 54 и 55 од ЗКП	АСЈО
Примена на начелото за неказнување на ЖТЛ во кривична и административна постапка	Најден е соодветен модел за примена на начелото за неказнување на ЖТЛ	128. Формирање меѓуресорска група за наоѓање модел за имплементација на принципот на неказнување на ЖТЛ согласно со Конвенцијата на СЕ		1. ЈО на РМ 2. МВР/МП/Врховен суд/МО	2017-2018	Состав на работната група	Нема
		129. Разгледување и утврдување најсоодветен модел што ќе значи правна основа за практична имплементација на начелото за неказнување во РМ, меѓу кои и препораките од спроведената анализа на ОБСЕ и НК за примена на начелото за неказнување во РМ		1. ЈО на РМ 2. МВР/МП/Врховен суд/МО	2017-2018	Вид модел за практична имплементација на начелото за неказнување на ЖТЛ	Нема





Qeveria e Republikës së Maqedonisë

Komisioni Kombëtar për Luftimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Migrimit Ilegal

STRATEGJIA  
KOMBËTARE PËR  
LUFTIMIN E  
TRAFIKIMIT  
TË QENIEVE  
NJERËZORE DHE  
MIGRIMIT ILEGAL  
NË REPUBLIKËN  
E MAQEDONISË  
2017 – 2020



Botimi dhe shërbimet konsulente për hartimin e këtij dokumenti janë siguruar nga IOM.  
Përmbajtja e këtij publikimi nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet ose qëndrimet e IOM-it.

Të nderuar,

Për shumicën e njerëzve është i pabesueshëm fakti që në shekullin 21 njerëzit janë objekt i trafikimit me njerëz dhe migrimit ilegal. Miliona njerëz anembanë botës janë viktime të trafikimit të qenieve njerëzore dhe migrimit ilegal. Nga kjo pikurë nuk është e përjashtuar as Republika e Maqedonisë.

Para jush është strategjia e katërt kombëtare dhe plani i veprimit për luftimin e trafikimit me njerëz dhe migrimit ilegal për periudhën kohore 2017 – 2020. Ky dokument, si dhe të mëhershmit, është hartuar nga Komisioni Kombëtar për luftimin e trafikimit me njerëz dhe migrimit ilegal. Strategjia paraqet një reflektim të gjendjes aktuale në këtë fushë dhe njëkohësisht një vizion për përmirësimin e vazhdueshëm të aktiviteteve koordinuese, avancimin e kornizës ligjore dhe zbatimin e rritur, si dhe të vepruarit parandalues të mëtutjeshëm në luftën kundër trafikimit me njerëz dhe migrimit ilegal.

Strategjia Kombëtare për luftimin e trafikimit me njerëz dhe migrimit ilegal është dokument strategjik që parasheh masa dhe aktivitete për institucionet kombëtare në drejtim të zbulimit dhe ndjekjes së autorëve të veprave penale dhe përmirësimit të gjendjes së viktimave të trafikimit me njerëz dhe migrimit ilegal në Republikën e Maqedonisë.

Këta dy dokumente janë si rrjedhojë e përkushtimit të Komisionit dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë në luftën kundër trafikimit me njerëz dhe migrimit ilegal. Strategjia bazohet në iniciativa që duhet t'i parandalojnë trafikimin me njerëz dhe migrimin ilegal, të zbulojnë, hetojnë dhe përpunojnë procedura juridike kundër autorëve të veprave të paligjshme, si dhe të sigurojnë përkrahje për personat-viktima të këtyre veprave të paligjshme, përfshi dhe mbrojtjen e lirive dhe të drejtat e njeriut.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe Komisioni Kombëtar mbeten fuqimisht të përkushtuar që të punojnë në partneritet me qeveritë dhe organizatat tjera ndërkombëtare, si dhe me sektorin qytetar për të përballuar këtë veprim çnjerëzor dhe të paligjshëm. Çdokush në shoqëri bartë një pjesë të përgjegjësisë në ballafaqimin e këtyre të ligave.

Strategjia Kombëtare për luftimin e trafikimit me njerëz dhe migrimit ilegal, si dhe plani i saj i veprimit i përcaktojnë aktivitetet e ardhshme të institucioneve kombëtare me qëllim ballafaqimin e këtij lloji të krimit. Gjatë katër viteve të ardhshëm presim përparim të matshëm dhe të vazhdueshëm përmes përpjekjeve të përbashkëta të të gjitha palëve të interesuara.

Republika e Maqedonisë është e përkushtuar ndaj ardhmërisë në të cilën do të zvogëlohet në maksimum numri i viktimave të trafikimit me njerëz dhe migrimit ilegal, me theks të veçantë respektimin e të drejtave të viktimës/migrantit, si dhe ri-integrimin e tyre. Kemi nderin dhe kënaqësinë t'ju paraqesim Strategjinë Kombëtare për luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe migrimit ilegal për vitet 2017 – 2020.

Koordinatori Kombëtar  
Sanja Dimitrievska

## PËRMBAJTJA

I. Strategjia Kombëtare për luftimin e trafikimit me njerëz dhe migrimit ilegal

II. Plani Kombëtar i Veprimit për luftimin e trafikimit me njerëz dhe migrimit ilegal

## 1. Trafikimi i qenieve njerëzore

Sipas nenit 3 (a) të Protokollit të KB për parandalimin, ballafaqimin dhe ndëshkimin e trafikimit me njerëz, veçanërisht të grave dhe fëmijëve (Protokolli i Palermos), i cili e plotëson Konventën e KB për luftën kundër krimit të organizuar trans-nacional (2000), „trafikimi i qenieve njerëzore” paraqet rekrutimin, transportimin, transferimin, ruajtjen ose pranimin e një personi, me përdorimin e mënyrave siç është kërcënimi ose përdorimi i forcës ose formave të tjera të detyrimit, grabitja, mashtrimi, keqpërdorimi i forcës ose keqpërdorimi i pozitës së cenueshme ose dhënia ose pranimi i pagesave ose dobive për të fituar pëlqimin e personit që ka kontroll mbi një person tjetër, me qëllim eksploatimin. Eksploatimi përfshin eksploatimin minimal të prostitucionit të personave tjerë ose forma të tjera të eksploatimit seksual, shërbime ose punë të detyruar, skllavëri ose forma të tjera të skllavërisë, robëri ose heqje të organeve.

Sipas nenit 3 (b) të Protokollit të Palermos së KB, rekrutimi, transportimi, ruajtja dhe pranimi i një fëmije me qëllim eksploatimin, do të konsiderohet si „trafikim me njerëz” edhe në ato raste kur nuk janë të përfshirë mjetet e cekura në paragrafin (a). Sipas nenit 3 (ç) të Protokollit të Palermos së KB, „fëmijë” konsiderohet secili person që nuk i ka mbushur 18 vjet..

## 2. Puna e detyruar

Sipas Konventës së ILO (shq. ONP) mbi punën e detyruar nr. 29 (1930), termi „punë e detyruar” nënkupton çdo punë ose shërbim që detyrohet nga një person tjetër duke u kërcënuar me çfarëdolloj ndëshkimi dhe për të cilën gjë ai person nuk është pajtuar me vullnetin e tij/saj të lirë.

## 3. Robëria

Sipas nenit 1 të Konventës së KB për robërinë (1926), robëria paraqet një status ose gjendje të një personi mbi të cilin shfaqet forcë si e drejtë pronësie.

## 4. Kontrabanda

Sipas Protokollit të KB për kontrabandën e migrantëve përmes tokës, ujit dhe ajrit, i cili e plotëson Konventën e KB për luftën kundër krimit të organizuar trans-nacional (2000), „kontrabanda e migrantëve” nënkupton përfitimin, e drejtpërdrejtë ose tërthortë, financiar ose material përmes hyrjes ilegale në shtetin në të cilin personi nuk është shtetas ose banor i përhershëm.

## 5. Migrimi ilegal

Sipas Organizatës Ndërkombëtare të Migrimit (IOM), migrimi ilegal ka të bëjë me format më të shpeshta të migrimit të parregullt, sidomos hyrjes ilegale, qëndrimit ose punës së paautorizuar, dhe përcaktohet si lëvizje që ndodh jashtë normave ligjore të shteteve që dërgojnë, përmes së cilave kalohet transit dhe të cilat pranojnë migrantë.



6. Grupe të rrezikuara	Persona të përjashtuar nga shoqëria: materialisht të pasiguruar, pjesëtarë të komuniteteve të caktuara etnike, persona/fëmijë të eksploatuar në punë, persona/fëmijë lypsar, persona/fëmijë që kanë probleme me familjen, fëmijë të përjashtuar nga procesi arsimor, fëmijë që jetojnë pa prindër/kujdestar të caktuar, fëmijë nga institucione, të mitur të paarsimuar/kryerës të veprave penale, viktimat të dhunës në familje.
7. Identifikimi	Një sërë procedurash dhe masash të institucioneve kompetente, të cilat në bazë të rrethanave në të cilat është gjetur VPTNJ, drejtohen kah grumbullimi i informacioneve dhe fakteve me qëllim përcaktimin e elementeve të trafikimit me njerëz.
8. Viktimë e veprës penale <sup>1</sup>	Paraqet një person që ka pësuar dëm, përfshi lëndim fizik ose psikik, pësim emocional, humbje materiale ose ndonjë lëndim tjetër ose cenim të të drejtave dhe interesave të tyre si rrjedhojë e një vepre të kryer penale.
9. Viktimë e trafikimit me njerëz	Paraqet një person në bazë të dëshmisë së të cilit ose rrethanave në të cilat është gjetur ai/ajo, tregojnë se ai/ajo është objekt i rekrutimit, transportimit, transferimit, strehimit ose pranimit për qëllime eksploatimi. Ky person është vënë në pozitë të cenueshme me përdorimin e „kërcënimit ose përdorimit të forcës, grabitjes, mashtrimit, gënjeshtërisë ose keqpërdorimit të pushtetit”.
10. Viktimë potenciale e trafikimit me njerëz	Paraqet një person për të cilën në bazë të gjendjes së cenueshme ose rrethanave në të cilat gjendet, ekzistojnë tregues se është viktimë e trafikimit me njerëz, mirëpo identifikimi i të cilit ende nuk ka mbaruar.
11. Fëmijë <sup>2</sup>	Personi që ende nuk i ka mbushur 18 vjet.
12. Fëmijë i pashoqëruar-i huaj	Fëmijë i pashoqëruar-i huaj që gjendet në territorin e RM dhe i cili në çastin e identifikimit është në moshë deri 18 vjet, nuk është i shoqëruar nga prindërit e tij ose nga një kujdestar të caktuar me ligj ose pas mbërritjes së tij në RM ka mbetur pa një shoqërim të tillë.

<sup>1</sup> KPP i RM, neni 21, alineja 4.

<sup>2</sup> Konventa e KB mbi të drejtat e fëmijës.

13. Mekanizëm kombëtar i referimit	Paraqet sistem bashkëpunimi përmes së cilit institucionet qeveritare i realizojnë përgjegjësitë e tyre për mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të njeriut për viktimat e trafikimit me njerëz. Kjo ndërlihet me futjen e mekanizmave në nivel kombëtar, kështu mund të sigurohet sistem efikas i identifikimit, referimit, pranimit, ndihmës dhe mbrojtjes së viktimave. Zyra e Mekanizmit Kombëtar për Referim funksionon pranë Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale që nga shtatori i vitit 2005.
14. Mekanizëm trans-nacional i referimit	Janë mekanizma dhe sisteme që janë përgatitur për ndihmë gjithëpërfshirëse dhe përkrahje trans-nacionale të viktimave. Mekanizmat trans-nacional të referimit e ndërlihin tërë procesin e referimit nga identifikimi fillestar deri në kthimin dhe ndihmën në vendet transitore, vendet e synuara dhe vendet e origjinës, përfshi dhe bashkëpunimin ndërmjet institucioneve qeveritare me SHQ dhe ON.
15. Procedurat Standarde të Veprimit (PSV)	PSV i rregullojnë procedurat, proceset dhe mënyrat e sigurimit të ndihmës dhe mbrojtjes së të gjithë viktimave të trafikimit me njerëz dhe migrimit ilegal përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse të bazuar në të drejtat e njeriut dhe përqendrohen në viktimat në formë të kornizës institucionale të bashkëpunimit.
16. Mbrojtja dhe ndihma	Masa, programe dhe shërbime qëllimi i të cilave është rehabilitimi i viktimave, sipas nenit 6 të Protokollit të Palermos të KB. Këto masa mund të ofrohen nga organizata joqeveritare, qeveritare dhe ndërkombëtare në vendet e synuara, transitore dhe të origjinës. Këto masa mund të përfshijnë – por jo vetëm kaq – strehimin, shërbime shëndetësore, ndihmë psikologjike, edukime, trajnime profesionale, punësim, ndihmë juridike dhe transport.
17. Ri-integrimi	Ri-integrimi i viktimave është ribashkimi me familjen, komunitetin ose integrimin e tyre në komunitet të ri. Përveç vetë aktit të kthimit, kjo, gjithashtu përfshin dhe integrimin e viktimës në një mjedis shoqëror me zgjidhje afatgjate sociale dhe ekonomike.
18. Kthimi	Kthimi i një personi në shtetin e tij/saj dhe/ose komunitetin e origjinës. Në kontekstin e aktiviteteve për luftimin e trafikimit me njerëz, kthimi nuk nënkupton vetëm transportimin fizik të viktimës, por dhe mekanizma që sigurojnë kthim të sigurt dhe me dinjitet.
19. Siguruesi/ofruesi i shërbimeve	Personal profesional i organizatave dhe institucioneve kompetente që sigurojnë shërbime për viktimat e trafikimit me njerëz (punëtorë social, psikologë, juristë, punëtorë mjekësor, etj.).

20. Strehimore/qendër akomodimi	Objekte që sigurojnë strehimin e përkohshëm të viktimave të supozuara dhe viktimave të trafikimit me njerëz, si dhe ofrojnë akomodim afatshkurtër dhe/ose afatgjatë.
21. Mbrojtja e dëshmitarëve	Masa sigurie të nevojshme për sigurimin e sigurisë së viktimës gjatë procedurave juridike. Mbrojtja e dëshmitarëve mund të ofrohet gjatë ose pas mbarimit të procedurave penale dhe mund të përfshijë një ose më tepër masa të parashikuara me Ligjin për mbrojtjen e dëshmitarëve.

## LISTA E SHKURTESAVE

<b>APRM</b>	Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë
<b>AGjPP</b>	Akademia e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publik
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>BNjVL</b>	Bashkësia e njësive të vetëqeverisjes lokale
<b>BSP</b>	Byroja e Sigurimit Publik
<b>BZHA</b>	Byroja për Zhvillimin e Arsimit
<b>DAP</b>	Drejtoria e të Ardhurave Publike
<b>DBPN</b>	Departamenti për Bashkëpunim Policor Ndërkombëtar
<b>DÇKM</b>	Departamenti për Çështje Kufitare dhe Migrim
<b>DIF</b>	Drejtoria e Inteligjencës Financiare
<b>DKP</b>	Departamenti i Krim Policisë
<b>DLKOS</b>	Departamenti për Luftimin e Krimin të Organizuar dhe Serioz
<b>DNjS</b>	Departamenti i Njësive Speciale
<b>DUDNJ</b>	Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut
<b>EHP</b>	Ekipe hetimore të përbashkëta
<b>ELAL</b>	Ekstrakt nga Libri Amë i të lindurve
<b>FPH</b>	Fëmijë i pashoqëruar-i huaj
<b>GjEDNj</b>	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
<b>ICMPD</b>	Qendra Ndërkombëtare për Zhvillimin e Politikave të Migrimit
<b>IOM</b>	Organizata Ndërkombëtare për Migrim
<b>IP</b>	Institucion publik
<b>IPQNPS</b>	Institucion publik – Qendra Ndërkombëtare për Punë Sociale
<b>IPQPS</b>	Institucion publik – Qendra për Punë Sociale
<b>ISHP</b>	Inspektorati Shtetëror i Punës
<b>KDF</b>	Konventa e KB për të Drejtat e Fëmijëve
<b>KE</b>	Këshilli i Evropës
<b>KE</b>	Komisioni Evropian

<b>KEDNj</b>	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
<b>KK</b>	Komisioni Kombëtar
<b>KL</b>	Komision Lokal
<b>KP</b>	Kodi Penal
<b>KPP</b>	Kodi për Procedurë Penale
<b>KPRrH</b>	Kategoria e personave të rrezikuar-të huaj
<b>LDF</b>	Ligji për Drejtësi për Fëmijët
<b>LKTNjdheMI</b>	Lufta kundër trafikimit me njerëz dhe migrimit ilegal
<b>LMO</b>	Ligji për Marrëdhënie të Obligacionit
<b>MARRI</b>	Qendra Rajonale e Iniciativës Rajonale për Migrim, Azil dhe Refugjatë
<b>MASH</b>	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
<b>MeD</b>	Ministria e Drejtësisë
<b>MeSH</b>	Ministria e Shëndetësisë
<b>MI</b>	Migrim ilegal
<b>MKR</b>	Mekanizmi Kombëtar për Referimin e viktimave të trafikimit me njerëz
<b>MPB</b>	Ministria e Punëve të Brendshme
<b>MPH</b>	Masa të posaçme hetimore
<b>MPJ</b>	Ministria e Punëve të Jashtme
<b>MPPS</b>	Ministria e Punës dhe Politikës Sociale
<b>MTR</b>	Mekanizmi Trans-nacional për Referim
<b>NjKNMHR</b>	Njësia për Krime Ndërkufitare, Migrime, të Huaj dhe Rikthim
<b>NjTNjKM</b>	Njësia kundër Trafikimit me Njerëz dhe Kontrabandës së Migrantëve
<b>NjVL-/VL</b>	Njësi të Vetëqeverisjes Lokale/Vetëqeverisja lokale
<b>OJQ</b>	Organizata joqeveritare
<b>OKB</b>	Organizata e Kombeve të Bashkuara
<b>ON</b>	Organizata ndërkombëtare
<b>OQ</b>	Organizata qytetare
<b>OQ</b>	Organizata qeveritare
<b>OSBE</b>	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
<b>PDK</b>	Përfaqësi Diplomatike Konsullore
<b>PKV</b>	Plani Kombëtar i Veprimit

<b>PLV</b>	Plan Lokal i Veprimit
<b>PNDESK</b>	Pakti Ndërkombëtar për të Drejta Ekonomike, Sociale dhe Kulturore
<b>PNDQP</b>	Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Qytetare dhe Politike
<b>PSV</b>	Procedura Standarde të Veprimit
<b>PThP</b>	Prokuroria Themelore Publike
<b>PV</b>	Plan i Veprimit
<b>PV LTNj</b>	Plan Veprimi për luftimin e trafikimit me njerëz
<b>PVLTF</b>	Plan Veprimi për luftimin e trafikimit me fëmijë
<b>QD</b>	Qendër ditore
<b>QIQ</b>	Qendra e Iniciativave Qytetare
<b>QNPS</b>	Qendra Ndërkombëtare për Punë Sociale
<b>QPH</b>	Qendra për pranimin e të huajve
<b>QPS</b>	Qendra e Punëve Sociale
<b>QPVTNj</b>	Qendra për Persona-Viktima të Trafikimit me Njerëz
<b>QR për ÇK</b>	Qendra Rajonale për Çështje Kufitare
<b>RK</b>	Raportuesi Kombëtar
<b>RM</b>	Republika e Maqedonisë
<b>SHPQ</b>	Shërbime Policore Qendrore
<b>SHQ</b>	Shoqata Qytetare që veprojnë në fushën e parandalimit, ndihmës, përkrahjes dhe mbrojtjes së viktimave të trafikimit me njerëz
<b>SK</b>	Strategjia Kombëtare
<b>SPB</b>	Sektor i Punëve të Brendshme
<b>TAIEX</b>	Instrumenti i Komisionit Evropian për Ndhmë Teknike dhe Shkëmbim të Informacioneve
<b>TNj</b>	Trafikimi me njerëz
<b>UNHCR</b>	Komisariati i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë
<b>UNICEF</b>	Fondi Ndërkombëtar për Fëmijë i Kombeve të Bashkuara
<b>UMC</b>	Unaccompanied migrant child
<b>VPTNj</b>	Viktimë potenciale e trafikimit me njerëz
<b>VSTNj</b>	Viktimë e supozuar e trafikimit me njerëz
<b>VTNj</b>	Viktimë e trafikimit me njerëz
<b>ZP</b>	Zyrtar policor

## Përmbajtja

HYRJE .....	84
1. Metodologjia e hartimit .....	85
2. Karakteristikat kyçe të Strategjisë Kombëtare 2017 - 2020 dhe Planit Kombëtar të Veprimit për luftimin e trafikimit me njerëz dhe migrimit ilegal .....	86
2.1 Karakteristikat kryesore novatore të Strategjisë Kombëtare dhe Planit Kombëtar të Veprimit .....	87
2.1.1 Korniza përkrahëse .....	87
2.1.2 Parandalimi .....	87
2.1.3 Identifikimi dhe referimi i VTNj .....	87
2.1.4 Ndihma e drejtpërdrejtë, mbrojtja, integrimi dhe kthimi vullnetar i viktimave të trafikimit me njerëz/migrantëve .....	87
2.1.5 Zbulimi dhe ndjekja penale efikase e autorëve të veprave penale për trafikim me njerëz dhe kontrabandë të migrantëve .....	88
3. Forcimi i politikave dhe veglave ekzistuese .....	88
3.1 Forcimi i kapaciteteve institucionale të institucioneve dhe organeve koordinuese .....	88
3.2 Përqendrimi i forcuar për zbulimin e rasteve të TNj dhe ndjekjen penale të autorëve, identifikimi dhe të drejtat e VTNj .....	88

4. Orientimet strategjike lidhur me përmirësimin e parandalimit, mbrojtjes, kthimin e sigurt dhe rehabilitimin e viktimave të trafikimit me njerëz dhe migrimit ilegal në bazë të Planit Kombëtar të Veprimit për vitet 2017 - 2020 .....	89
4.1 Parimet kryesore të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit në luftën kundër trafikimit me njerëz dhe migrimit ilegal .....	89
4.2 Analiza e gjendjes dhe vlerësimi i kornizës ekzistuese institucionale .....	91
4.3 Tendencat e trafikimit me njerëz dhe migrimit ilegal në Republikën e Maqedonisë .....	91
4.4 Korniza institucionale për luftimin e trafikimit me njerëz .....	92
4.5 Mekanizmat përkrahës të institucioneve qeveritare .....	92
4.5.1 Komisioni Kombëtar për luftimin e trafikimit me njerëz dhe migrimit ilegal .....	93
4.5.2 Raportuesi Kombëtar i Republikës së Maqedonisë .....	93
4.5.3 Zyra e Koordinatorit Kombëtar .....	93
4.5.4 Zyra e Mekanizmit Kombëtar për Referim (MKR) .....	93
4.6 Institucionet qeveritare dhe shërbimet që i ofrojnë shoqatat e qytetarëve .....	94
5. Orientimet strategjike lidhur me përsosjen e kornizës institucionale dhe operative në kuadër të PKV 2017 - 2020 .....	95
5.1 Standard Korniza juridike për luftimin e trafikimit me njerëz dhe politika e ndjekjes penale .....	95
5.2 Orientimet strategjike për përmirësimin e kornizës juridike .....	97
6. FUSHAT STRATEGJIKE .....	98
7. Rrezik-faktorët për realizimin e Strategjisë Kombëtare (SK) dhe Planit të Veprimit (PV) .....	104

Qëllimi dhe metodologjia e hartimit të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për luftimin e trafikimit me njerëz dhe migrimit ilegal për vitet 2017 – 2020

### Qëllimi i përgjithshëm, misioni dhe objektivat

Republika e Maqedonisë tashmë pesëmbëdhjetë vite po bën përpjekje të vazhdueshme për ballafaqimin e organizuar të trafikimit me njerëz dhe migrimit ilegal me qëllim që në mënyrë aktive të përfshihet në përpjekjet e komunitetit ndërkombëtar për parandalimin dhe luftimin e kësaj dukurie të dëmshme si një ndër format më të rënda të krimit të organizuar.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë zotohet për zbatim të suksesshëm të qëllimeve strategjike dhe aktivitetëve të Strategjisë me qëllim përaftrimin e mëtejshëm të vendit me standardet e komunitetit ndërkombëtar. Në këtë drejtim, gjatë hartimit të Strategjisë Kombëtare u morën seriozisht parasysh: Rekomandimet e bëra nga Këshilli i Evropës, në raportin e GRETA për RM<sup>3</sup> për Vlerësimin e zbatimit të Konventës së Këshillit të Evropës „Aktivite kundër trafikimit me njerëz“, Rekomandimet e përfaqësuesit të posaçëm dhe koordinatorit për trafikim me njerëz të OSBE-së të bëra në Raportin e vizitës së RM,<sup>4</sup> si dhe dokumente të tjera strategjike dhe praktika të mira të BE-së dhe OSBE-së<sup>5</sup>. Për më tepër, u analizuan dhe interpretuan raportet përkatëse të Departamentit të Shtetit të SHBA-së dhe dokumente të tjera të rëndësishme kombëtare dhe ndërkombëtare.

Republika e Maqedonisë shënon përparim të vazhdueshëm në këtë fushë. Dëshmi për këtë janë edhe raportet e BE-së dhe Departamentit të Shtetit të SHBA-së, si dhe raportet e organizatave të tjera relevante ndërkombëtare. Prapë se prapë, kohëve të fundit, Evropa dhe Lindja e Afërt u ballafaquan me një fluks të madh të refugjatëve nga vende të ndryshme të botës, ndërsa mes tyre numër më të madh përbënin personat-viktima të trafikimit me njerëz dhe migrimit ilegal. Evropa u sfidua me një shtypje të paparë në historinë bashkëkohore. As Republika e Maqedonisë nuk ishte përjashtim nga kjo. Ky realitet i ri nxiti një angazhim të rritur të institucioneve kombëtare, organizatave ndërkombëtare dhe sektorit qytetar. Njëkohësisht, nga gjendja e re e krijuar, doli nevoja e formimit të një vizioni të ri për ballafaqimin e formave të reja të migrimit, trafikimit me njerëz dhe migrimit ilegal.

Prandaj, qëllimi i përgjithshëm i Strategjisë Kombëtare për luftimin e trafikimit me njerëz dhe migrimit ilegal është të nxit mirëkuptim më të madh për tendencat dhe zhvillimet e reja në këtë fushë në nivel botëror, si dhe përmirësim të mekanizmave koordinuese për ballafaqimin e kësaj dukurie.

Misioni i Strategjisë Kombëtare është të sigurojë prioritet strategjike për luftimin e trafikimit me njerëz dhe të hartojë qëllime të përgjithshme dhe konkrete për institucionet kompetente, veç e veç dhe në grup, si në nivel lokal ashtu edhe në nivel kombëtar. Misioni i Strategjisë është të sigurojë shërbime më cilësore për viktimat dhe të intensifikojë masat parandaluese dhe represive për ballafaqimin me veprat penale që rrjedhin nga ato vepra. Plani kombëtar i veprimit duhet të nxit operacionalizim të objektivave të përcaktuara, të sigurojë përkrahje të gjerë politike dhe financiare për zbatimin

e aktivitetëve të parashikuar në planin e veprimit. Plani Kombëtar i Veprimit përmban 5 fusha strategjike: 1. Kornizën përkrahëse, 2. Parandalimin, 3. Identifikimin dhe referimin, 4. Ndhimën e drejtpërdrejtë, mbrojtjen, integrimin dhe kthimin vullnetar të VTNj/migrantëve, dhe 5. Zbulimin dhe ndjekjen efikase të autorëve të veprave penale-trafikim me njerëz dhe kontrabandë të migrantëve.

Në të janë precizuar objektivat dhe prioritetet, rezultate që duhet të arrihen, janë përcaktuar institucionet që duhet të jenë bartës së aktivitetëve, korniza kohore për realizimin e tyre, treguesit e matjes së performancës së realizimit të detyrave, si dhe korniza financiare për zbatimin e aktivitetëve të planifikuara. Tërë kjo duhet të nxit rritjen e mirëbesimit të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë në parimin e sundimit të shtetit të së drejtës, mirëbesimin e rritur në institucione, përmirësimin e gjendjes së lirive dhe të drejtave të njeriut, të ndalohet trafikimi me njerëz dhe të rritet ndërgjegjësimi për trafikimin me njerëz dhe migrimit ilegal, si dhe të përmirësohet imazhi i Republikës së Maqedonisë në plan ndërkombëtar.

## 1. Metodologjia e hartimit

Strategjia Kombëtare 2017 – 2020 dhe Plani Kombëtar i Veprimit u hartuan me ndihmën e ekspertëve dhe konsulentëve të huaj<sup>6</sup>, si dhe në bazë të vlerësimit paraprak për plotësimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit Kombëtar të Veprimit 2013 – 2016 nga një vlerësues i pavarur<sup>7</sup>.

Për hartimin e Strategjisë Kombëtare u morën parasysh: Raporti i vlerësuesit të pavarur, raportet e Komisionit Kombëtar, raportet vjetore të Raportuesit Kombëtar, analiza e procedurave standarde të veprimit, raportet e OJQ-ve, raportet e Bashkimit Evropian dhe të Departamentit të Shtetit të SHBA-ve, raporte të tjera të rëndësishme nga organizata dhe institucione kombëtare dhe ndërkombëtare, hulumtime jozyrtare, vlerësime dhe analiza. Gjithashtu, u realizua edhe një analizë e legjislacionit vendor, të legjislacionit të Bashkimit Evropian, të legjislacionit ndërkombëtar, si dhe një analizë për zbatimin e legjislacionit ekzistues nga institucionet dhe organet kompetente kombëtare. Për më tepër, u realizuan disa takime pune dhe punëtori me qëllim përmirësimin cilësor të tekstit të Strategjisë Kombëtare dhe Planit Kombëtar të Veprimit. Në fund, mirëpo jo më pak e rëndësishme, Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit u hartuan në bazë të përvojës së fituar nga realizimi i masave dhe politikave të mëhershme kundër luftimit të trafikimit me njerëz dhe migrimit ilegal nga institucionet kombëtare, organizatat ndërkombëtare dhe shoqatat e qytetarëve, por edhe nga mësimet e fituara dhe praktikatat më të mira në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar. Hartimi i dokumenteve kryesore bazohet në parimin e përfshirjes, ndërsa gjatë të cilit u morën parasysh një numër i madh i mendimeve dhe pikëpamjeve nga aktorë të ndryshëm.

<sup>3</sup> Raporti i RM është miratuar në takimin e 14-të të Komisionit të palëve të Këshillit të Evropës më 7 korrik 2014.

<sup>4</sup> Vizita e Ambasadores znj. Madina Jarbusinova, përfaqësuese e posaçme dhe koordinatore e OSBE-së në luftën kundër trafikimit me njerëz, është realizuar më datë 23-26 mars 2015.

<sup>5</sup> Strategjia e BE-së për çrënjësjen e TNj 2012-2016, Direktiva 2011/36/EU për parandalimin dhe luftimin e TNj dhe mbrojtjen e viktimave, Plani i Veprimit i OSBE-së kundër TNj 2003-2013 dhe Vendimi 1.107 amendament për plotësimin e PV-së.

<sup>6</sup> Konsulentët që e hartuan SK dhe PKV: Sando Kitanov dhe Jovan Andonovski dhe vlerësuesi i SK dhe PKV 2013-2016 u përkrahën financiarisht nga Misioni i IOM në Shkup.

<sup>7</sup> Vlerësimi i Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për luftimin e trafikimit me njerëz dhe migrimit ilegal në Republikën e Maqedonisë (2013-2016), Autori prof. d-r Sunçica Dimitrijoska, u përkrah financiarisht nga Misioni i IOM në Shkup, 2016.

## 2. Karakteristikat kyçe të Strategjisë Kombëtare 2017 – 2020 dhe Planit Kombëtar të Veprimit për luftimin e trafikimit me njerëz dhe migrimit ilegal

Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit për luftimin e trafikimit me njerëz dhe migrimit ilegal janë në korrelacion me Strategjinë e fundit të BE-së për çrrënjosjen e trafikimit me njerëz 2012 – 2016, si dhe me Planin e Veprimit për luftimin e trafikimit me njerëz të OSBE-së dhe Amendamentit të tij nga viti 2013 për luftimin e trafikimit me njerëz: një dekadë më vonë, por edhe me qëndrimet e BE-së për migrimin, i cili ka marr hov të madh viteve të fundit.

Rrjedhimisht, si aktivitete prioritet, janë theksuar çështjet në vijim:

Forcimi i kapaciteteve institucionale të institucioneve kombëtare dhe SHQ-ve për sigurimin e reagimit në fushën e:

- koordinimit dhe bashkëpunimit të përmirësuar dhe rritur ndërmjet aktorëve kryesor, si dhe harmonizim të politikave kombëtare;
- efikasitetit dhe efektivitetit gjatë zbatimit të objektivave strategjike të planifikuara përmes përpilimit të planeve operative vjetore për zbatimin e PKV dhe PV për luftimin e TNj me fëmijë në bazë të vlerësimit paraprak dhe nivelit të zbatimit të tyre;
- sigurimit të profesionalizmit dhe pavarësisë gjatë krijimit dhe zbatimit të politikave;

- pavarësisë dhe qëndrueshmërisë financiare gjatë zbatimit të politikave të institucioneve qeveritare dhe SHQ-ve;
- numrit të zmadhuar të rasteve të zbuluara të trafikimit me njerëz dhe ndjekjes penale të autorëve;
- ndjekjes së tendencave të trafikimit me njerëz dhe migrimit ilegal në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;
- përmirësimit dhe rritjes së identifikimit të VTNJ dhe kategorive të tjera të grupeve të rrezikuara;
- përmirësimit dhe rritjes së identifikimit të kategorive të migrantëve të rrezikuar;
- përmirësimit dhe parandalimit të trafikimit me njerëz dhe migrimit ilegal;
- sigurimit të ndihmës adekuate, përkrahjes, mbrojtjes dhe ri-integrimit të viktimave të identifikuara nga trafikimi me njerëz/migrantët ilegal, veçanërisht fëmijët viktimë të trafikimit me njerëz dhe FPH (fëmijët e pashoqëruar të huaj).

Duke i pasur parasysh tendencat e ndryshueshme në fushën e migrimit ilegal, gjatë hartimit të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit u morën parasysh edhe qëndrimet e BE-së për agjendën e re të Bashkimit Evropian për migrimin:

1. zvogëlimi i migrimit ilegal – përmes hetimeve, parandalimit dhe ndjekjes penale të autorëve të veprave penale nga kontrabanda e migrantëve;
2. forcimi i kontrollit kufitar me qëllim identifikimin e kategorive të migrantëve të rrezikuar, viktimave të mundshme të trafikimit me njerëz dhe fëmijëve të pashoqëruar të huaj;
3. politika të kontrolluara mbi azilin;
4. harmonizimi me politikën e reja të BE-së për migrimin ilegal.

### SHQ

Me qëllim forcimin e pozitës së Koordinatorit Kombëtar, Strategjia Kombëtare parashikon masa dhe aktivitete që përqendrohen në ngritjen e kapaciteteve të Zyrës së Koordinatorit Kombëtar.

#### 2.1 Karakteristikat kryesore novatore të Strategjisë Kombëtare dhe Planit Kombëtar të Veprimit

##### 2.1.1 Korniza përkrahëse

1. forcimi i kapaciteteve të Zyrës së Koordinatorit Kombëtar;
2. forcimi i kapaciteteve financiare, njerëzore dhe teknike të institucioneve qeveritare dhe SHQ-ve në zbatimin e politikave;
3. forcimi i bashkërendimit dhe bashkëpunimit ndërmjet institucioneve në nivel qendror, lokal dhe rajonal për identifikimin, ndihmën dhe përkrahjen e viktimave të mundshme dhe grupeve të rrezikuara;
4. harmonizimi i legjislacionit kombëtar me atë ndërkombëtar;
5. gjetja e modelit adekuat për ngritjen e Fondit për kompensim të viktimave nga trafikimi me njerëz;
6. hulumtimi i gjendjes së trafikimit me njerëz me qëllim monitorimin dhe vlerësimin e politikave.

##### 2.1.2 Parandalimi

1. përcaktimi i rrezeve dhe grupeve të rrezikuara nga paraqitja e dukurisë së TNj dhe MI në RM,
2. identifikimi i manifestimeve/tendencave të TNj/fëmijë, MI;
3. ngritja e vetëdijesimit publik për TNj/fëmijë dhe MI, mani-

festimet dhe rreziqet;

4. ngritja e vetëdijesimit të kategorive të identifikuara të personave të rrezikuar ndaj TNj, manifestimeve dhe rreziqeve;
5. gjetja dhe avancimi i mekanizmave më efikase për zbutjen e shkaqeve/nivelit të rrezikut nga TNj/fëmijë;
6. ngritja e vetëdijesimit publik për TNj për arsye eksploatimi, si dhe për pasojat mbi viktimën dhe shfrytëzuesit e shërbi- meve nga VTNJ.

##### 2.1.3 Identifikimi dhe referimi i VTNJ

1. përsosja dhe zbatimi i metodave proaktive për zbulimin dhe identifikimin e VTNJ-ve të mundshëm, me theks të veçantë fëmijët VTNJ;
2. përfshirja aktive e më shumë institucioneve/agjencive qeveritare dhe SHQ-ve në zbulimin dhe identifikimin e VTNJ;
3. qasje proaktive në zbulimin e VTNJ të mundshëm ndërmjet kategorive të migrantëve/refugjatëve të rrezikuar, posaçërisht të FPH-ve;
4. ngritja e kapaciteteve të punonjësve në PDK në fushën e identifikimit të VTNJ-ve të mundshëm gjatë procesit të aplikimit për viza hyrëse në RM.

##### 2.1.4 Ndihma e drejtpërdrejtë, mbrojtja, integrimi dhe kthimi vullnetar i viktimave të trafikimit me njerëz/migrantëve

1. sigurimi i mbrojtjes për viktimat dhe migrantët ilegal në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare;
2. integrimi i VTNJ/migrantëve në mjedisin shoqëror, të cilëve iu është miratuar qëndrim i përkohshëm në RM;
3. sigurimi i mjeteve për kthim vullnetar të VTNJ/migrantëve.

### 2.1.5 Zbulimi dhe ndjekja penale efikase e autorëve të veprave penale për trafikim me njerëz dhe kontrabandë të migrantëve

1. Formimi i një grupi pune shumë disiplinor kombëtar (Task Force) për të punuar me rastet e trafikimit me njerëz.
2. Zbatimi i hetimeve penale proaktive kundër të gjithë kryerësve të veprave penale për trafikim me njerëz, njëkohësisht zbatimi edhe i hetimeve financiare për konstatimin e fitimit nga ato vepra penale;
3. Mbrojtja e të drejtave të kategorive të dëshmitarëve/viktimave në pajtim me nenin 54 dhe 55 të KP;
4. Zbatimi i parimit të mosndëshkimit të viktimave të trafikimit me njerëz në procedurë penale.

## 3. Forcimi i politikave dhe veglave ekzistuese

### 3.1 Forcimi i kapaciteteve institucionale të institucioneve dhe organeve koordinuese

Me qëllim reagimin efikas dhe efektiv ndaj TNj nga institucionet kombëtare, theksi është vënë në forcimin e kapaciteteve në fushën e kapaciteteve njerëzore, materiale dhe teknike dhe në fushën e identifikimit, mbrojtjes, ndihmës dhe përkrahjes së VTNj-ve.

Në pajtim me objektivat strategjike të përcaktuara për harmonizimin dhe përmbushjen e standardeve ndërkombëtare dhe rekomandimeve të Këshillit të Evropës në fushën e forcimit të kapaciteteve, forcimi i kapaciteteve të Zyrës së Koordinatorit

Kombëtar dhe përcaktimi i një modeli për forcimin e funksionit të Raportuesit Kombëtar janë objektiva strategjike të kësaj Strategjie Kombëtare.

### 3.2 Përqendrimi i forcuar për zbulimin e rasteve të TNj dhe ndjekjen penale të autorëve, identifikimi dhe të drejtat e VTNj

Karakteristikë e Strategjisë së viteve 2013-2016 është numri i zvogëluar dukshëm i VTNj-ve të identifikuar. Përqendrimi i kësaj Strategjie është dhënë në masa dhe objektiva strategjike të planifikuara që synojnë forcimin e kapaciteteve të institucioneve dhe profesionistëve të përfshirë në procesin e zbulimit të rasteve të TNj, ndjekjen penale të autorëve, identifikimin e shpejtë dhe në kohë të VTNj-ve, mbrojtjen e tyre adekuate, ndihmën dhe përkrahjen për respektimin e plotë të të drejtave të tyre.

## 4. Orientimet strategjike lidhur me përmirësimin e parandalimit, mbrojtjes, kthimin e sigurt dhe rehabilitimin e viktimave të trafikimit me njerëz dhe migrimit ilegal në bazë të Planit Kombëtar të Veprimit për vitet 2017 – 2020

### 4.1 Parimet kryesore të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit në luftën kundër trafikimit me njerëz dhe migrimit ilegal

Parimet kryesore pasqyrohen përmes fushave strategjike dhe objektivave të përcaktuara sipas katër komponentëve themelore të aktiviteteve në luftën kundër trafikimit me njerëz dhe migrimit ilegal, përkatësisht korniza përkrahëse, parandalimi, përkrahja dhe mbrojtja e viktimave dhe migrantëve, si dhe procedura para hetimore dhe penale kundër trafikimit me njerëz dhe kontrabandës së migrantëve.

#### Parimi i 1-rë. Përgjegjësia Qeveritare për Strategjinë

Qeveria e Republikës së Maqedonisë merr përgjegjësi për përcaktimin e objektivave, zbatimin e aktiviteteve dhe synon arritjen e rezultateve pozitive nga zbatimi i aktiviteteve si një përgjigje kombëtare ndaj problemit të trafikimit me njerëz dhe migrimit ilegal.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë, në periudhën e zbatimit të dokumenteve strategjike, duhet të sigurojë mjete financiare për realizimin e objektivave strategjike. Për këtë qëllim,

institucionet kompetente për planifikimin dhe zbatimin e aktiviteteve të parashikuara në Strategjinë Kombëtare dhe Planin e Veprimit duhet të parashikojnë masa qëndrueshmërie. Gjithashtu, institucionet kombëtare duhet të planifikojnë mobilizim të zmadhuar të burimeve njerëzore, si dhe forcimin e vazhdueshëm të kapaciteteve të tyre me qëllim arritjen e maksimumit të efekteve nga realizimi i aktiviteteve të parashikuara në Strategjinë Kombëtare dhe Planin Kombëtar të Veprimit.

#### Parimi i 2-të. Pjesëmarrja e sektorit qytetar

Qeveria e Republikës së Maqedonisë luan një rol dominues në ballafaqimin e sfidave dhe problemeve që janë si rrjedhojë e trafikimit me njerëz dhe migrimit ilegal. Prapë se prapë, ballafaqimi me këto dukuri të padëshiruara mund të ketë intensitet të lartë dhe rezultate më të mira në qoftë se Qeveria krijon partneritet të vazhdueshëm me sektorin qytetar. Për këtë qëllim, Qeveria e Republikës së Maqedonisë vërteton se edhe gjatë hartimit edhe gjatë zbatimit të programeve, masave dhe aktiviteteve për luftimin e trafikimit me njerëz dhe migrimit ilegal, do të vendos dialog aktiv me (të gjithë) aktorët relevant që janë jashtë sistemit të qeverisjes. Shoqatave të qytetarëve do iu mundësohet krijimi i mëtejme i marrëdhënieve partnere dhe një rol aktiv në zbatimin e analizave dhe hulumtimeve, zbatimin e aktiviteteve parandaluese, edukimin, sigurimin e ndihmës dhe përkrahjes së viktimave nëpër strehimore dhe në procesin e ri-integrimit në mjedisin shoqëror.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë parasheh marrëdhënie partnere afatgjate me shoqatat e qytetarëve që tregojnë profesionalizëm, përkushtim dhe siguri përmes përpilimit të kritereve (në qoftë se ekzistojnë, të rishikohen ose të përmirësohen) për zgjedhjen e shoqatave të qytetarëve që do të përfshihen në ofrimin e ndihmës dhe mbrojtjes për viktimat e

trafikimit me njerëz dhe migrimit ilegal, të cilat do t'i përkrah me financa.

### **Parimi i 3-të. Trajtimi i viktimave në bazë të të drejtave të njeriut**

Strategjia Kombëtare për luftimin e trafikimit me njerëz dhe migrimit ilegal bazohet në standardet ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut, veçanërisht ato që gjenden në Konventën Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, Konventën për statusin e refugjatëve, si dhe protokolleve përkatëse.<sup>8</sup>

1. E drejta e jetës (neni 2).
2. E drejta për të mos qenë i nënshtruar ndaj torturës, trajtimit çnjerëzor dhe degradues (neni 3).
3. Ndalimi i robërisë dhe punës së detyruar (neni 4).
4. E drejta të mos mbahet peng në mënyrë të paligjshme (neni 5).
5. E drejta për gjykim të drejtë (neni 6).
6. Mos diskriminimi në bazë të racës, religjionit ose vendit të prejardhjes (neni 3).
7. Ndalesa për dëbimin e refugjatëve (neni 33).
8. Respektimi i të drejtave të parashikuara në konventat ndërkombëtare të ratifikuara nga RM.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë vërteton se mekanizmat kombëtare të identifikimit, mbrojtjes dhe referimit të viktimave, si dhe i tërë procesi gjyqësor, janë në pajtueshmëri të plotë me këtë qasje të të drejtave të njeriut. Qeveria synon avancimin e mëtejshëm të mbrojtjes së të drejtave të viktimave me qëllim sigurimin e informacioneve juridike, mbrojtje fizike dhe juridike, ndihmë materiale dhe kompensim, të cilat shpijnë në rehabilitimin dhe integrimin e tyre të qëndrueshëm.

Parandalimi i trafikimit me njerëz dhe mbrojtja adekuate është prioritet i përhershëm i Qeverisë së RM dhe është identifikuar si një ndër sfidat kryesore në periudhën e ardhshme.

### **Parimi i 4-t. Koordinimi ndër-disiplinor dhe qasja pjesëmarrëse**

Qeveria e Republikës së Maqedonisë merr përsipër të sigurojë bashkërendim ndër-disiplinor në drejtim të zbatimit të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit. Gjithashtu, Komisioni Kombëtar do të sigurojë pjesëmarrje të të gjithë institucioneve kombëtare kompetente dhe të interesuara për planifikimin, realizimin dhe promovimin e aktiviteteve të parashikuara me Strategjinë Kombëtare dhe Planin e Veprimit.

### **Parimi i 5-të. Qëndrueshmëria**

Me qëllim sigurimin e qëndrueshmërisë dhe realizueshmërisë së Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit, Qeveria e Republikës së Maqedonisë krijon mekanizma të monitorimit dhe vlerësimit, të cilat do të synojnë ndjekjen e nivelit të real-

izimit të aktiviteteve të planifikuara në Strategjinë Kombëtare dhe Planin e Veprimit. Qeveria e Republikës së Maqedonisë synon që strukturat dhe veglat të jenë në funksion të plotë të realizimit të objektivave të përcaktuara në dokumentet strategjike, përmes sigurimit të mjeteve adekuate nga Buxheti i shtetit, si dhe përmes sigurimit të burimeve të nevojshme njerëzore, të përshtatura për planifikimin afatmesëm.

### **4.2 Analiza e gjendjes dhe vlerësimi i kornizës ekzistuese institucionale**

Trafikimi me njerëz dhe migrimi ilegal janë problem global që u bë i pranishëm edhe në Republikën e Maqedonisë. Migrimi ilegal ka tendencë rritjeje. Ekzistojnë kompetenca të kombinuara ndërmjet më tepër institucioneve për ballafaqimin e trafikimit me njerëz dhe migrimit ilegal, aktivitete këto të koordinuara nga Komisioni Kombëtar për luftimin e trafikimit me njerëz dhe migrimit ilegal. Komisioni përbëhet nga përfaqësues të institucioneve qeveritare, i drejtuar nga një Koordinator Kombëtar. Komisioni ka në dispozicion një trup administrativ, Sekretariatit dhe Nëngrupin për luftimin e trafikimit me fëmijë. Megjithëse veprimtaria ndër-dikasteriale jep rezultate, prapë se prapë nevojitet të shqyrtohet mundësia e forcimit të kapaciteteve të Zyrës së Koordinatorit kombëtar, si dhe përcaktimi i një modeli për forcimin e funksionit të Raportuesit Kombëtar, të cilat janë ndër rekomandimet kyçe të Këshillit të Evropës në fushën e harmonizimit të legjisllacionit kombëtar me instrumentet juridike ndërkombëtare.

### **4.3 Tendencat e trafikimit me njerëz dhe migrimit ilegal në Republikën e Maqedonisë**

#### **Analiza e gjendjes**

Analiza e gjendjes dhe tendencave tregon migrim në rritje me karakteristika të lëvizjeve të ndryshme të migrantëve dhe refugjatëve, mes të cilëve një pjesë e madhe i përkasin kategorisë së personave të rrezikuar, siç janë: fëmijë të pashoqëruar, VTNJ të mundshëm, prindër të vetëm me fëmijë, persona në moshë dhe persona me aftësi të kufizuara.

Është vërejtur një rritje e madhe e numrit të migrantëve ilegal dhe pritet që kjo tendencë të vazhdojë të ekzistojë edhe gjatë disa viteve të ardhshëm. Shpeshherë bëhet fjalë për migrantë që udhëtojnë transit nëpër Republikën e Maqedonisë, pasi që vendi paraqet kryqëzim të korridoreve ndërkombëtare. Ekziston e ashtuq. ruta e „Ballkanit Perëndimor“, nëpër të cilën, vetëm gjatë dy viteve të fundit, kanë kaluar mbi një milion migrantë dhe një numër i madh i migrantëve ilegal.

Vendet nga të cilat më së shumti vijnë migrantët ilegal janë Siria, Afganistani, Pakistani, vendet e Lindjes së Afërt dhe të Largët, si dhe Afrika. Migrantët ilegal shpeshherë hyjnë në Republikën e Maqedonisë në kufirin jugor me Greqinë, në zonën e Komunës së Gjevgjelisë dhe rrethinës së saj. Nga vendi dalin shpeshherë në kufirin verior, në drejtim të Serbisë, përmes kalimeve ilegale në zonën e komunave Kumanovë dhe Likovë. Për më tepër, në disa raste janë zbuluar edhe qendra ilegale gjatë hyrjes dhe daljes në vend. Gjithashtu ekziston një rutë edhe drejt Republikës së Kosovës, e cila shfrytëzohet si alternativë e korridorit ekzistues me Republikën e Serbisë. Transiti përmes Republikës së Maqedonisë kryhet në mënyrë të organizuar nga grupet kriminale. Transporti më së shpeshti kryhet me automjete për pasagjerë ose me autobusë, përkatësisht tren. Është i

<sup>8</sup> Referimi drejt KEDNj dhe Konventës për statusin e refugjatëve të KB-ve.



konsiderueshëm edhe numri i fëmijëve të pashoqëruar të huaj. Jo rrallë herë, për shkak të numrit të madh të migrantëve ilegal, nëpër kufij, ndodhin edhe incidente dhe tensione, për të cilën gjë u angazhua një numër i madh i pjesëtarëve të forcave të sigurisë me qëllim parandalimin e hyrjes në vend të migrantëve ilegal ose të peregjistruar. Që të prapësohen hyrjet ilegale, të kontrollohet dhe kanalizohet fluksi i migrantëve drejt vendkalimeve kufitare legale, u ngrit një mur sigurie, i përforcuar nëpër ato pjesë të kufirit për të cilat ekzistonte dyshim se shfrytëzohen si vendkalime ilegale. Forcat e sigurisë së Maqedonisë arritën të parandalojnë hyrjen e më shumë se shtatë mijë migrantëve ilegal vetëm gjatë vitit 2016.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë kërkoi ndihmë dypalëshe edhe nga vendet anëtare të BE-së me ofrimin e mbikëqyrjes së kufirit dhe pajisjeve, si dhe me transferimin e policisë kufitare për t'i ndihmuar policisë maqedonase me patrulla, regjistrim dhe identifikim dhe me kontrolle sigurie. Deri më tani vetëm disa shtete kanë dërguar zyrtarë policorë: Kroacia, Hungaria, Serbia, Sllovenia, Çekia, Sllovakia dhe Austria.

Gjithashtu, luftimi i trafikimit me njerëz ende paraqet sfidë për shtetin. Republika e Maqedonisë ende paraqet vendin e origjinës, transitit dhe destinacionit, si dhe ekzistimi i TNJ-së së brendshme me qëllim eksploatimin seksual dhe të punës. Shpeshherë bëhet fjalë për kategori të personave të rrezikuar, të nxitur nga faktorë të ndryshëm shoqëror, ekonomik dhe social siç janë: varfëria, diskriminimi gjinor, dhuna në familje dhe gjendje të tjera të viktimës, përkatësisht moshë, gjendja shëndetësore, nevojat e posaçme, etj. Në periudhën e viteve 2013 – 2015, u identifikuan 27 viktima të trafikimit me njerëz. Prej tyre, 18 fëmijë dhe 9 të rritur. Shtetas të Maqedonisë janë 19 persona, ndërsa 8 janë të shtetas të huaj. Viktima të trafikimit me njerëz janë 27 persona që kanë qenë objekt i eksploatimit, edhe atë: të punës – 3 persona, seksual – 9 persona, të punës dhe seksual – 9 persona dhe martesë të detyruara – 6

persona. Më së shpeshti bëhet fjalë për gra. Rrjedhimisht, institucionet kompetente kanë evidentuar 244 lëndë të trafikimit me njerëz dhe migrimit ilegal. Në periudhën e viteve 2013 – 2015, për trafikim me njerëz dhe migrim ilegal, janë dorëzuar denoncime kundër 388 personave, ndërsa janë shqiptuar aktgjykime për 186 persona. Prej tyre, 11 janë me kusht në liri, ndërsa 175 janë në vuajtje të dënimit me burg.

#### 4.4 Korniza institucionale për luftimin e trafikimit me njerëz

Republika e Maqedonisë i ngrit kapacitetet e saj për balafaqimin e trafikimit me njerëz dhe migrimit ilegal qysh në vitin 2001. Ekzistojnë institucione me kompetenca të përgjithshme në këtë fushë, siç janë: Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Shëndetësisë, Prokuroria Themelore Publike për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit, etj.

#### 4.5 Mekanizmat përkrahës të institucioneve qeveritare

Ekziston edhe një trup i specializuar që quhet Komisioni Kombëtar për luftimin e trafikimit me njerëz dhe migrimit ilegal, i cili është formuar në vitin 2001. Ai është formuar me detyrë për: monitorimin dhe analizën e gjendjes lidhur me trafikimin me njerëz dhe migrimin ilegal, koordinimin e aktiviteteve të institucioneve kompetente brenda dhe jashtë sistemit të Qeverisë, si dhe për organizimin dhe realizimin e bashkëpunimit me organizata përkatëse ndërkombëtare dhe shoqata të qytetarëve. Komisionin e përbëjnë 15 anëtarë, të deleguar nga institucionet e sipërpërmendura.<sup>9</sup>

#### 4.5.1 Komisioni Kombëtar për luftimin e trafikimit me njerëz dhe migrimit ilegal

Për funksionimin e Komisionit Kombëtar është vendosur një sistem themelor për punë dhe koordinim. Komisioni punon me takime dhe funksionon në bazë të bashkëpunimit dhe informimit ndërinstitucional. Për punën e vet, Komisioni jep informacione dhe raporte. Institucionet- anëtare të Komisionit Kombëtar, në mënyrë të ndërsjellë, bashkëpunojnë, shkëmbejnë informacione dhe i realizojnë aktivitetet e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit.

Në kuadër të Komisionit Kombëtar ekziston edhe Sekretaria-ti, i cili është formuar në vitin 2003 dhe e përbëjnë përfaqësues të institucioneve qeveritare, përfaqësues të organizatave ndërkombëtare, shoqata të qytetarëve, etj.

Gjithashtu, në kuadër të Komisionit Kombëtar ekziston edhe Nëngrupi për luftimin e trafikimit me fëmijë. Aktivitetet e këtij trupi synojnë parandalimin e trafikimit me fëmijë dhe përmirësimin e mbrojtjes së të miturve-viktima, si dhe koordinimin e bashkëpunimit ndërmjet palëve të interesuara.<sup>10</sup>

#### 4.5.2 Raportuesi Kombëtar i Republikës së Maqedonisë

Në Republikën e Maqedonisë, Raportuesi Kombëtar për trafikimin me njerëz është krijuar me propozim të Komisionit Kombëtar, ndërsa është emëruar nga Qeveria e RM në vitin 2015. Në bazë të mandatit të tij, Raportuesi Kombëtar është përgjegjës për: mbikëqyrjen e aktiviteteve të përgjithshme të luftës kundër trafikimit me njerëz, grumbullimin dhe analizën e të

dhënave nga partnerët relevant, monitorimin dhe vlerësimin e realizimit të PKV, sjelljen e konkluzioneve dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin dhe përsosjen e luftës kundër trafikimit me njerëz në relacion me zbatimin e ligjeve, politikave për reagim më të mirë institucional, rekomandimet e rishikimit të objektivave strategjike dhe përpilimit të raportit vjetor. Çdo vit, Raportuesi Kombëtar dorëzon raport përkatës.

#### 4.5.3 Zyra e Koordinatorit Kombëtar

Zyra e Koordinatorit Kombëtar gjendet në kuadër të MPB-së dhe është themeluar në vitin 2007. Qëllimi i Zyrës është t'i sigurojë përkrahje logjistike dhe teknike Komisionit Kombëtar. Që në vitin 2009, Zyra e Koordinatorit Kombëtar është e institucionalizuar.

#### 4.5.4 Zyra e Mekanizmit Kombëtar për Referim (MKR)

Zyra e Mekanizmit Kombëtar për Referim (MKR) është institucionalizuar që në vitin 2009 në kuadër të MPPS – Departamenti për Mundësi të Barabarta. Roli i MKR është të sigurojë identifikim adekuat, ndihmë dhe mbrojtje, në bazë të standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut për viktimat e trafikimit me njerëz, veçanërisht fëmijëve të mitur, si dhe pa dallim të prejardhjes etnike, moshës ose gjinisë. MKR bashkëpunon edhe me institucionet dhe aktorë të tjerë në procesin e parandalimit, identifikimit, përkrahjes dhe mbrojtjes së viktimave të trafikimit me njerëz, sidomos trafikimit me fëmijë.

<sup>9</sup> MPB, MPJ, MPPS, PTHP për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit, Gjykata Themelore Shkup 1, MeD, MASH dhe MeSH.

<sup>10</sup> Nëngrupin e kryeson këshilltari për mbrojtjen dhe parandalimin e trafikimit me njerëz nga MPPS - MKR, ndërsa marrin pjesë pjesëtarë të MPB, përfaqësues të PDK të huaj, organizata ndërkombëtare, shoqata të qytetarëve dhe zëvendës Avokati i Popullit në rolin e anëtarit/vëzhguesit të jashtëm.

#### 4.6 Institucionet qeveritare dhe shërbimet që i ofrojnë shoqatat e qytetarëve

##### **Qendra e Pranimi për të Huaj/Qendra për persona-viktima të trafikimit me njerëz**

Në Republikën e Maqedonisë ekzistojnë dy objekte në të cilat bëhet pranimi dhe strehimi i viktimave të vendit dhe të huaja nga trafikimi me njerëz/fëmijë.

**Qendra e pranimi për të huaj** është një objekt në pronësi shoqërore, e drejtuar nga MPB dhe është në funksion qysh në vitin 2001. Qendra shërben për strehimin e shtetasve të huaj, viktimave të supozuara dhe viktimave të trafikimit me njerëz. Në Qendrën e pranimi për të huaj, personave të strehuar iu ofrohet akomodim, ndihmë dhe mbrojtje mjekësore, këshilla juridike dhe përfaqësim dhe përkrahje psikosociale, si dhe shërbime për kthimin dhe ri-integrimin e tyre. Në Qendrën e pranimi për të huaj, gjatë vitit 2015 janë strehuar 56% më tepër persona sesa vitin e kaluar, përkatësisht ishin strehuar 1,346 (896) persona, pjesa dërmuese e të cilëve ose 75% janë shtetas nga Siria, Afganistani dhe Iraku.

Janë formuar edhe dy qendra: Qendra e Përkohshme Transit – Gjevgjeli dhe Qendra e Përkohshme Transit – Tabanovcë, të cilat shërbejnë për pranimin, evidentimin, lëshimin e certifikatave për qëllimin e shprehur për azil dhe përgatitjen e migrantëve për transportimin e mëtejshëm. Gjithashtu, në afërsi të kufirit me Republikën e Serbisë, tek vendkalimi kufitar „Tabanovcë“ është formuar një Qendër e përkohshme për transit, i cili shërben për migrantët që kanë udhëtuar transit nëpër vendin tonë, ta kalojnë kufirin drejt Republika Serbisë. Kapaciteti i përgjithshëm i të dy qendrave për pranim (Gjevgjeli dhe Tabanovcë) është gjithsej 2.000 vende, 1.500 vende në Gjevgjeli dhe 500 në Tabanovcë. Ato funksionojnë me ndihmën e

institucioneve kompetente të Republikës së Maqedonisë (MPB, MPPS, MeSH), si dhe me ndihmën dhe përkrahjen e organizatave joqeveritare dhe ndërkombëtare. Ekipet e Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë vazhdimisht iu sigurojnë përkrahje migrantëve; gjatë qëndrimit të tyre në qendrat e përkohshme për transit iu ofrohet ndihmë mjekësore, ushqim dhe ujë, batanije, rroba dhe mjete për higjienë personale. Në qendrat e pranimi janë të pranishëm dhe organizata ndërkombëtare dhe shoqata qytetare, të cilat gjithashtu iu ndihmojnë migrantëve.

**Qendra për persona-viktima të trafikimit me njerëz** është strehimore shtetërore e MPPS-së, e formuar në vitin 2011. Në të strehohen viktimave të trafikimit me njerëz, shtetas të vendit dhe të huaj, të cilëve iu është miratuar qëndrimi i përkohshëm.

## 5. Orientimet strategjike lidhur me përsosjen e kornizës institucionale dhe operative në kuadër të PKV 2017 – 2020

Me qëllim sigurimin e qëndrueshmërisë së aktiviteteve në luftën kundër trafikimit me njerëz dhe migrimit ilegal, Komisioni Kombëtar do të sigurojë:

- kapacitete adekuate teknike dhe njerëzore dhe përkrahje financiare për avancimin e luftës kundër trafikimit me njerëz dhe migrimit ilegal;
- Komisioni Kombëtar zotohet të zhvillojë koordinim me pushtetin lokal, me qëllim ngritjen e kapaciteteve në luftën kundër trafikimit me njerëz në RM;
- Komisioni Kombëtar synon përmirësimin e sistemit të grumbullimit dhe përpunimit të të dhënave të sakta statistikore përmes krijimit të një baze të dhënash të centralizuar për viktimave dhe kryerës.

### 5.1 Standard Korniza juridike për luftimin e trafikimit me njerëz dhe politika e ndjekjes penale

**Analiza e hartimit të kornizës juridike** – është krijuar kornizë e gjerë për luftën kundër trafikimit me njerëz, e cila është përforcuar dhe harmonizuar me legjislacionin evropian dhe me standardet dhe të drejtën ndërkombëtare.

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë (neni 29) garanton se shtetasit e huaj në Republikën e Maqedonisë i gëzojnë liritë dhe të drejtat e garantuara me Kushtetutë, me kushte të përcaktuara me ligj dhe me marrëveshjet ndërkombëtare. Liritë dhe të drejtat themelore të migrantëve legal, të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, janë përpunuar në disa dispozita ligjore: e drejta për hyrje dhe qëndrim të shtetasve të huaj në Republikën e Maqedonisë, si dhe të drejtat dhe detyrimet e tyre, janë rregulluar me Ligjin për shtetasit e huaj<sup>11</sup>. Në bazë të Ligjit për shtetasit e huaj janë miratuar edhe aktet nënligjore me sa vijon:

1. Rregullore për shtetas të huaj;
2. Rregullore për dokumente udhëtimi dhe dokumente të tjera për të huajt;
3. Rregullore për rregullat e sjelljes në Qendrën e pranimi për të huajt;
4. Rregullore për mënyrën e lëshimit të vizave për të huajt, vazhdimin, shkurtimin e vlefshmërisë së tyre, revokimin dhe anulimin e vizave, si dhe formulari i vizave dhe mbajtjen e evidencës.

**Ligji për punësim dhe punësimin e të huajve**<sup>12</sup> - i rregullon kushtet sipas të cilave të huajt mund të punësohen dhe të punojnë në Republikën e Maqedonisë.

**Ligji mbi arsimin fillor** – e proklamoi parimin themelor se fëmijët me shtetësi të huaj që qëndrojnë në Republikën e Maqedonisë kanë të drejtë për arsim fillor me kushte të njëjta sikur edhe fëmijët-shtetas të Republikës së Maqedonisë.

<sup>11</sup> Fletorja zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 35/2006, 66/2007, 117/2008, 92/2009, 156/2010, 158/2011, 84/12, 13/13,217/2015).

<sup>12</sup> Fletorja zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 70/2007, 5/2009, 35/2010, 148/2011, 84/2012, 217/2015).

**Ligji mbi arsimin e mesëm** – parashikon që shtetasit e huaj të mund të fitojnë arsim të mesëm dhe të kenë të drejtë të kërkojnë nostrifikim të dëftesave të fituara në vende të huaja.

**Ligji mbi arsimin sipëror** – parashikon që shtetasit e huaj mund të regjistrojnë studimet e tyre nën kushtet e njëjta sikur edhe shtetasit e Republikës së Maqedonisë. Shtetasve të huaj mund t’iu shkurtohet ose kufizohet regjistrimi në qoftë se bëhet fjalë për studime që kanë të bëjnë me arsimin ushtarak ose policor ose studime që janë në interes të sigurisë kombëtare.

**Ligji për vullnetarizëm** – me këtë ligj rregullohet voluntarizmi, kushtet dhe mënyrat e kryerjes së voluntarizmit, të drejtat dhe detyrimet e vullnetarëve, si dhe evidenca e punës vullnetare. Ky ligj thekson se vullnetar mund të jetë secili person fizik, i vendit dhe i huaj.

**Ligji për mbrojtje shëndetësore** – e garanton shërbimin themelor shëndetësor për të gjithë shtetasit e huaj të punësuar në territorin e Republikës së Maqedonisë, të huaj që arsimohen ose janë në formim profesional në Republikën e Maqedonisë, të huaj që në territorin e Republikës së Maqedonisë janë me punë në organizata ndërkombëtare, përfaqësi konsullore të huaja ose në shërbim personal të shtetasve të huaj, të cilët gëzojnë imunitetet diplomatik.

**Ligji për sigurim shëndetësor** – me këtë ligj përcaktohet sigurimi shëndetësor i shtetasve të vendit dhe të huaj, të drejtat dhe detyrimet e sigurimit shëndetësor, si dhe mënyra e realizimit të sigurimit. Edhe ky ligj i rregullon të drejtat dhe kushtet e sigurimit shëndetësor për kategoritë e njëjta të shtetasve të huaj që janë theksuar në Ligjin për mbrojtje shëndetësore.

**Kodi penal** – i parashikon veprat penale trafikim me njerëz (neni 418-a), kontrabandë me migrantë (neni 418-b), orga-

nizim të grupit dhe nxitje për kryerje të veprave penale trafikim me njerëz dhe kontrabandë me migrantë (neni 418-c) dhe trafikim me fëmijë (neni 418-ç)

Ligji për shtetasit e huaj parashikon edhe dy vepra penale lidhur me migrimin, edhe atë:

- ndihmë shtetasit të huaj gjatë hyrjes së paligjshme dhe transitit;
- ndihmë shtetasit të huaj gjatë qëndrimit të paligjshëm.

Më 18 qershor 2015, u miratuan ndryshimet e **Ligjit për azil dhe mbrojtje të përkohshme**. Me këto ndryshime u bë dalim ndërmjet qëllimit për dorëzimin e kërkesës për azil dhe dorëzimit të vetë kërkesës për azil (për më shumë hollësi në pjesën për azil). Njëkohësisht, me këto ndryshime iu mundësua migrantëve të shprehin qëllimin për dorëzim të kërkesës për njohjen e të drejtës për azil. Qëllimet kryesore të këtyre ndryshimeve ishin:

- përmirësimi i kushteve të ndihmës mjekësore dhe humanitare për migrantët;
- rritja e sigurisë së migrantëve (zvogëlimi i numrit të veprave penale);
- zvogëlimi i numrit të aksidenteve hekurudhore dhe të trafikut në të cilat viktimat janë migrantët;
- zvogëlimi i numrit të kontrabandës së migrantëve;
- evidentimi më efikas i migrantëve që hyjnë në Republikën e Maqedonisë.

Janë hartuar **Procedura Standarde** për të vepruar me fëmijët e pashoqëruar-të huaj (PSV dhe FPH) dhe Procedura Standarde të Veprimit me kategoritë e rrezikuara të personave të huaj (PSV dhe KRrPH).

## 5.2 Orientimet strategjike për përmirësimin e kornizës juridike

Analiza teknike e hollësishme e kryer për legjislacionin kombëtar tregoi një nivel të lartë të harmonizimit me legjislacionin evropian në shumë direktiva të fushës.<sup>15</sup> Mirëpo, analiza e tregoi edhe nevojën e harmonizimit të mëtejshëm të legjislacionit kombëtar me Direktivën 2008/115/KE për standardet dhe procedurat e përbashkëta të vendeve anëtare për kthimin e shtetasve të vendeve të treta që janë me qëndrim të paligjshëm, si dhe me Direktivën 2011/98/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit më 13 dhjetor 2011 për procedurë të vetme të kërkesës së lejes së vetme për shtetas të vendeve të treta për të qëndruar dhe punuar në territorin e një vendi anëtar dhe për rregulla të përbashkëta të punëtorëve të vendeve të treta që ligjërisht qëndrojnë në shtetin anëtarë (Direktiva për leje të vetme).

Gjithashtu, duhet të merret parasysh edhe Direktiva 2011/36/BE për luftimin e TNj dhe të drejtat e VTNj.

Komisioni Kombëtar, me qëllim harmonizimin e legjislacionit kombëtar me instrumentet e të drejtës ndërkombëtare që e rregullojnë trafikimin me njerëz dhe migrimin ilegal do të:

- realizojë analizë të legjislacionit kombëtar me qëllim përcaktimin e nivelit të harmonizimit me instrumentet e të drejtës ndërkombëtare,
- propozojë propozim-amendamente për ndryshimin e legjislacionit të nevojshëm me qëllim harmonizimin e tij,
- Komisioni Kombëtar do të realizojë procedurë para ratifikimit me qëllim kryerjen e analizës për harmonizimin e instrumenteve juridike ndërkombëtare në vijim:
- Konventën nr. 189 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës „Për punë të denjë të ndihmësve shtëpiak“, e cila shërben si instrument i fuqishëm për parandalimin e trafikimit me njerëz për qëllime eksploatimi, veçanërisht për punë të detyruar në kushte vendore.
- Konventën ndërkombëtare të vitit 1990 për mbrojtjen e të drejtave për të gjithë punëtorët-migrantë dhe anëtarët e familjeve të tyre. Miratimi i kësaj konvente është e një rëndësie të veçantë sepse e konsideron faktin që Republika e Maqedonisë është bërë vend transiti dhe destinacioni për fluksin në rritje të migrantëve.

<sup>15</sup> Direktiva 2003/86/KE e Këshillit (22 shtator 2003) mbi të drejtën e ribashkimit të familjes. Direktiva 2003/109/KE e Këshillit (25 nëntor 2003) për statusin e shtetasve të vendeve të treta që janë banorë me qëndrim afatgjatë, e ndryshuar me Direktivën 2011/51/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit më 11 maj 2011. Direktiva e Këshillit 2005/71/KE (12 tetor 2005) mbi procedurën e posaçme për lejen e hyrjes së shtetasve të vendeve të treta për qëllime shkencore-hulumtuese. Direktiva e Këshillit 2004/114/KE (13 dhjetor 2004) për kushtet e pranimit të shtetasve të vendeve të treta për qëllime të studimit, shkëmbimit të nxënësve, trajnimit pa kompensim ose shërbimit vullnetar. Direktiva 2004/81/KE e Këshillit (29 prill 2004) për lejen e qëndrimit që iu lëshohet shtetasve të vendeve të treta që janë viktimat të trafikimit me njerëz ose të cilët kanë qenë objekt i lehtësimit të migrimit ilegal dhe të cilët kanë bashkëpunuar me autoritetet kompetente. Rregullativa (KE) nr. 1030/2002 e Këshillit (12 qershor 2002) për përcaktimin e formatit të njëtrajtshëm të leje-qëndrimit për shtetas të vendeve të treta.

## 6. FUSHAT STRATEGJIKE

Fushat strategjike të Strategjisë Kombëtare janë: korniza përkrahëse; parandalimi; identifikimi dhe referimi; ndihma e drejtpërdrejtë, mbrojtja, integrimi dhe kthimi vullnetar i VTNj/ migrantëve, si dhe zbulimi efikas dhe ndjekja penale e autorëve të veprave penale Trafikim me Njerëz dhe Migrim Ilegal.

OBJEKTIVI STRATEGJIK	REZULTATI I PRITUR
Forcimi i kapaciteteve të strukturave koordinuese	Janë forcuar kapacitetet e Zyrës së Koordinatorit Kombëtar; Janë forcuar kapacitetet e Raportuesit Kombëtar.
Ngritja e kapaciteteve njerëzore dhe teknike të MPB-së në luftën kundër TNj dhe MI	MPB/NjTNjKM janë plotësuar me zyrtarë policorë në pajtim me aktin e sistematizimit; Janë përmirësuar kapacitetet teknike për zbulim efikas.
Ngritja e kapaciteteve të MKR dhe QNPS/QPS	Është rritur efikasiteti i punës së MKR dhe QNPS/QPS; Në secilën QNPS/QPS janë shpërndarë punëtorë social me kompetenca për punën me VTNj.
Përkrahje financiare nga Qeveria e RM dedikuar SHQ-ve në fushën e parandalimit, ndihmës, përkrahjes dhe mbrojtjes së VTNj-ve	Janë siguruar mjete financiare për SHQ-të që do të punojnë në fushën e parandalimit, ndihmës, përkrahjes dhe mbrojtjes dhe VTNj-ve.
Funksionimi i plotë operativ i QVTNj	Është caktuar buxhet vjetor nga MPPS-MKR dhe është mundësuar funksionim operativ i QPVTNj; Janë forcuar kapacitetet njerëzore të MPPS-MKR/QNPS Shkup në fushën e ofrimit të ndihmës, mbrojtjes dhe përkrahjes së VTNj në QPVTNj; Janë përfshirë në mënyrë aktive SHQ-të e përzgjedhura për ofrimin e ndihmës psikosociale dhe përkrahjes për VTNj dhe QPVTNj.
Përmirësimi i kapaciteteve dhe kushteve të Qendrës për Pranim të të Huajve	Janë ngritur kapacitetet; janë përmirësuar kushtet për strehimin e të huajve, kategorive të rrezikuara të të huajve, FPH dhe familjeve.

## SHQ

Forcimi i kapaciteteve të komisioneve lokale për LTNjMI	Caktimi i buxhetit për zbatimin e PLV për TNj të komisioneve lokale: Manastir, Shtip, Gjevgjeli, Veles, Prilep dhe Tetovë. Identifikimi i komunave të cilat kanë nevojë për formimin e komisioneve lokale LTNjMI dhe formimi i komisioneve të reja lokale për LTNjMI.
Forcimi i rolit koordinues të KK-së dhe përmirësimi i transparencës gjatë zbatimit të aktiviteteve	Është siguruar funksionim dhe koordinim ndërmjet Komisionit Kombëtar, Sekretariatit, Nëngrupit për fëmijë dhe komisioneve lokale. Është siguruar efikasitet në zbatimin e politikave. Është siguruar transparencë në punën e Komisionit Kombëtar.
Harmonizimi i legjislacionit kombëtar me atë ndërkombëtar	Legjislacioni kombëtar është harmonizuar në tërësi me legjislacionin ndërkombëtar në fushën e TNj dhe të drejtat e VTNj/migrantëve; Ratifikimi i instrumenteve juridike ndërkombëtare. Rregullimi çështjes për formimin e një Fondi kombëtar për kompensimin e viktimave të veprave penale me përfshirjen e elementit-dhunë.
Vendosja dhe forcimi bashkëpunimit dhe koordinimit ndërkombëtar ndërmjet institucioneve përkatëse qeveritare dhe SHQ-ve në fushën e TNj dhe MI	Është vendosur dhe forcuar bashkëpunimi ndërkombëtar i institucioneve qeveritare dhe SHQ në fushën e TNj dhe MI.
Avancimi i sistemit për menaxhim me informacione	Komisioni Kombëtar dhe Raportuesi Kombëtar janë të informuar në kohë për aktivitetet e planifikuara dhe realizuara në pajtim me PKV nga institucionet qeveritare dhe SHQ-të.

Hulumtimi i gjendjes me TNj dhe MI, përcaktimi i karakteristikave dhe tendencave të dukurisë së trafikimit me njerëz në nivel kombëtar, veçanërisht të trafikimit me fëmijë për qëllime të eksploatimit seksual dhe të punës, martesave të detyruara dhe lypjes së detyruar, me qëllim të monitorimit dhe vlerësimit të politikave kombëtare

Dukuria e TNj dhe MI në RM është hulumtuar dhe analizuar siç duhet; janë përcaktuar karakteristikat dhe tendencat e TNj, veçanërisht TNj me fëmijë me qëllim eksploatimin seksual dhe të punës, si dhe martesave të detyruara.

Identifikimi i rreziqeve dhe grupeve të rrezikuara nga dukuria e TNj, trafikimit me fëmijë dhe MI në RM

Janë identifikuar rreziqet nga dukuria e TNj/trafikimi me fëmijë, MI dhe kategoritë e personave të rrezikuar, veçanërisht të fëmijëve.

Identifikimi i manifestimeve/tendencave të TNj/fëmijë, MI në nivel kombëtar

Janë identifikuar tendencat e reja të TNj në fushën e rekrutimit, transportimit/transferimit dhe llojeve të eksploatimit, si dhe trendeve të MI.

Janë forcuar kapacitetet e të punësuarve në sistemin arsimor dhe institucionet parashkollore në RM në fushën e TNj, veçanërisht për trafikimin me fëmijë.

Është rritur niveli i informimit të nxënësve në arsimin fillor/mesëm dhe studentëve në arsimin sipëror për TNj, manifestimet dhe rreziqet, me theks të veçantë rreziqet e trafikimit me fëmijë.

Forcimi i kapaciteteve të institucioneve kompetente qeveritare dhe SHQ-ve në fushën e parandalimit të TNj/trafikimit me fëmijë

Janë forcuar kapacitetet e inspektorëve të punës për zbulimin dhe parandalimin e eksploatimit në punë.

Është rritur niveli i informimit të punonjësve shëndetësor për TNj dhe manifestimet e tij.

Është rritur niveli i informimit dhe përgjegjësisë së mediave për TNj dhe manifestimet e tij.

Janë forcuar kapacitetet e punonjësve në PDK të RM në vendet e huaja rreth TNj, manifestimet dhe kategoritë e personave të rrezikuar.

Ngritja e vetëdijesimit publik rreth TNj/fëmijë dhe MI, manifestimet dhe rreziqet

Publiku është informuar në mënyrë të duhur për identifikimin e manifestimeve dhe rreziqeve të TNj/fëmijë dhe MI.

Ngritja e vetëdijesimit të kategorive të identifikuar të personave të rrezikuar rreth TNj, manifestimeve dhe rreziqeve

Është ngritur vetëdijesimi i kategorive të personave të rrezikuar për identifikimin e TNj/fëmijë, manifestimeve dhe rreziqeve.

Është ngritur vetëdijesimi i përfituesve të programit „Puno dhe Udhëto“ për identifikimin e rreziqeve të TNj me theks të veçantë rreziqet e eksploatimit në punë.

Avancimi dhe gjetja e mekanizmave më efikas për zbutjen e shkaqeve/rrezikut rreth dukurisë së TNj/fëmijë

Është përpiluar Program/Kurikulë kombëtare me përmbajtje mësimore dedikuar arsimit të mesëm dhe sipëror rreth TNj.

Janë ndërmarr masa administrative, ekonomike dhe sociale për kategoritë e personave të rrezikuar me qëllim zbutjen e rrezikut nga TNj.

Ngritja e vetëdijesimit për TNj me qëllim eksploatimin, për pasojat mbi viktimën, si dhe për ndëshkimin e shfrytëzuesve të shërbimeve nga VTNj

Është ngritur vetëdijesimi për pasojat nga TNj për vetë viktimën, si dhe ndëshkimin e shfrytëzuesve të shërbimeve nga VTNj.

Përsosja dhe zbatimi i metodave proaktive për zbulimin dhe identifikimin e VTNj të mundshëm, me theks të veçantë fëmijët VTNj

Zbatimi efikas i treguesve për identifikimin e VTNj dhe PSV për të vepruar me VTNj.

Përfshirja aktive e më tepër institucioneve/agjencive kombëtare dhe SHQ-ve në zbulimin dhe identifikimin e VTNj

Është zgjeruar numri i institucioneve/agjencive qeveritare dhe SHQ-ve në zbulimin dhe identifikimin e VTNj.

Qasje proaktive në zbulimin e VTNj-ve të mundshëm ndërmjet kategorive të migrantëve/refugjatëve të rrezikuar, veçanërisht të FPH

Janë identifikuar kategoritë e rrezikuara të shtetasve të huaj në mesin e migrantëve/refugjatëve, veçanërisht të FPH, si dhe është realizuar profilizimi i tyre me qëllim identifikimin e VTNj-ve të mundshëm.

Ngritja e kapaciteteve të punonjësve të MPJ/PDK në fushën e identifikimit të VTNJ-ve të mundshëm gjatë aplikimit për viza hyrëse në RM	Punonjësit e MPJ që janë me punë në PDK të RM në vendet e huaja të aftësohen për identifikimin e VTNJ-ve të mundshëm në mesin e kërkuesve për viza.
Sigurimi i mbrojtjes dhe ndihmës për VTNJ dhe migrantëve ilegal në pajtim me standardet ndërkombëtare	Është siguruar vend i sigurt për strehim dhe është ofruar ndihma e parë për VTNJ dhe migrantë në pajtim me standardet ndërkombëtare. Janë forcuar kapacitetet e kuadrit profesional në QPVTNJ dhe Qendrën e Pranimit për të Huaj.
Integrimi në mjedisin shoqëror i VTNJ/kategorive të migrantëve/azilkërkuesve të rrezikuar, të cilëve iu është miratuar qëndrim i i përkohshëm në RM	VTNJ të mundshëm, kategoritë e migrantëve të rrezikuar dhe kategoritë e tjera të migrantëve janë informuar rreth të drejtave dhe detyrimeve të tyre, si dhe iu është siguruar ndihmë juridike dhe përkrahje. Janë realizuar vazhdimisht programet e ndihmës, përkrahjes dhe ri-integrimit të VTNJ/migrantëve/azilkërkuesve.
Është formuar një grup pune në nivel kombëtar (Task force) për punën e rasteve të TNj	Është formuar grup kombëtar pune (Task force) për punën e rasteve të TNj.
Realizimi i hetimeve kriminale proaktive kundër të gjithë autorëve të veprave penale TNj, njëkohësisht realizimi i hetimeve financiare për konstatimin e fitimit kriminal nga vepra penale e caktuar	Janë planifikuar me sukses dhe janë realizuar në mënyrë efikase hetimet kriminale proaktive kundër TNj.
Rritja e bashkëpunimit policor ndërkufitar në fushën e TNj dhe KM	Është rritur bashkëpunimi; janë shkëmbyer informacione dhe janë realizuar hetime të përbashkëta për TNj dhe KM.
Forcimi i kapaciteteve të PP dhe gjykatave për zhvillimin e kallëzimeve penale me qëllim ndjekjen efikase të autorëve të TNj	Prokurorët publik dhe gjykatësit janë trajnuar për të gjitha format e TNj, mënyrat e kryerjes së veprës penale dhe sekuestrimin e pasurisë.

Mbrojtje e të drejtave të kategorive të dëshmitarëve/viktimave të rrezikuar në procedurë penale në pajtim me nenin 54 dhe 55 të KPP	Gjatë procedurës penale, dëshmitarëve/viktimave të kategorisë së rrezikuar nga TNj i u janë siguruar të drejtat në pajtim me dispozitat e nenit 54 dhe 55 të KPP.
Zbatimi i parimit të mosndëshkimit për VTNJ-të në kallëzimet penale	Është gjetur model i përshtatshëm për zbatimin e parimit të mosndëshkimit të VTNJ-ve.

## 7. Rrezik-faktorët për realizimin e Strategjisë Kombëtare (SK) dhe Planit të Veprimit (PV)

Si rrezik-faktorë për realizimin e SK dhe PV janë identifikuar treguesit vijues: koha e realizimit të SK dhe PV, personeli dhe buxheti.

Korniza kohore e realizimit të SK dhe PV zgjat 4 vjet që paraqet kohë të mjaftueshme për arritjen e objektivave të SK dhe PV. Prapë se prapë, në kushte të ndryshimeve politike, ekonomike dhe juridike të shpeshta dhe të shpejta, si dhe të ndryshimeve që shkaktohen nga fluksi i rritur i migrantëve nga Lindja e Afërt, Azia dhe Afrika, drejt Evropës, ekziston mundësia të ndodh ndryshimi i prioriteteve dhe radhitjes së realizimit të objektivave të SK dhe PV. Në atë rast, ekziston rrezik të tejkalohet korniza kohore e realizimit të SK dhe PV.

Gjithashtu, rrezik tjetër që duhet parashikuar është edhe mungesa e personelit të disa institucioneve që kanë përsipër zbatimin e një pjese të aktiviteteve të parashikuara me SK dhe PV. PV parashikon masa për tejkalimin e kësaj gjendjeje, të cilat duhet të sigurojnë forcimin e kapaciteteve të strukturave koordinuese.

E fundit, por shumë e rëndësishme, rrezik për realizimin e SK dhe PV është sigurimi i mjeteve financiare për zbatimin e objektivave dhe rezultateve të pritura nga SK dhe PV. Për këtë qëllim, nevojitet përkushtimi i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe alokimi i mjeteve buxhetore adekuate dedikuar institucioneve përkatëse për zbatimin e objektivave dhe rezultateve të pritura.

PLANI  
KOMBËTAR I  
VEPRIMIT PËR  
LUFTIMIN  
E TRAFIKIMIT  
TË QENIEVE  
NJERËZORE  
DHE MIGRIMIT  
ILEGAL  
NË REPUBLIKËN  
E MAQEDONISË  
2017-2020

QËLLIMI STRATEGJIK	REZULTATI I PRITUR	AKTIVITETI		1. Institucioni kompetent, ON/SHQ - bartës i aktivitetit	KORNIZA KOHORE	TREGUESI	BUXHETI/BARTËS I BUXHETIT
				2. Institucioni, ON/SHQ-pjesëmarrës i aktivitetit			

## 1. KORNIZA MBËSHTETËSE

### 1.1 Ngritja e kapaciteteve institucionale:

Ngritja e kapaciteteve të strukturave koordinuese	Ngritja e kapaciteteve të Zyrës së Koordinatorit Kombëtar	1. Përzgjedhja dhe angazhimi i bashkëpunëtorëve profesional që do të zënë vendet e punës në Zyrën e Koordinatorit Kombëtar (KK)		KK/MPB	2017-2018	Numri i bashkëpunëtorëve të zgjedhur profesional	Nuk ka
		2. Pajimi material-teknik i Zyrës së Koordinatorit Kombëtar në pajtim me nevojat e punonjësve të zgjedhur rishtazi		KK-MPB	2017-2018	Lloji dhe sasia e pajisjeve materiale-teknike	MPB
	Janë forcuar kapacitetet e Raportuesit Kombëtar	3. Zbatimi i analizës krahasuese për praktikën më të mira të BE-së në lidhje me forcimin e pozitës së Raportuesit Kombëtar		RK/MPB	2017-2018	Është përpiluar analiza krahasuese	MPB
		4. Përcaktimi i një modeli që do të kontribuojë në forcimin e pozitës së Raportuesit Kombëtar		RK/MPB	2017-2018	Është përcaktuar modeli	MPB
Ngritja e kapaciteteve njerëzore dhe teknike të MPB në luftimin e TNj dhe MI	MPB/NjTNjKM Janë punësuar bashkëpunëtorë profesional në pajtim me Aktin e sistematizimit, janë përmirësuar kapacitetet teknike për zbulim efikas	5. Publikimi i shpalljes së brendshme nga ana e DLKOS për zgjedhjen e bashkëpunëtorëve profesional në NjTNjKM në pajtim me Aktin e sistematizimit		MPB/DLKOS	2017-2018	Numri i vendeve të lira të punës të plotësuar në pajtim me Aktin e sistematizimit	MPB
		6. Propozim ndryshim i Aktit të sistematizimit të vendeve të punës në MPB, me qëllim përcaktimin e vendeve të punës në kuadër të SPB – Departamenti i çështjeve kriminale/zyra të jashtme për çështje kriminale pranë stacioneve të policisë me kompetenca të përgjithshme, QR për ÇK/NjKNMHR, të cilët do të jenë kompetent për të vepruar në raste të TNj		MPB/BSP	2017	Numri i Aktit për ndryshimin e sistematizimit	Nuk ka
		7. Trajnimi i bashkëpunëtorëve profesional të sapo pranuar në NjTNjKM dhe bashkëpunëtorëve profesional të pozicionuar përgjegjës për të vepruar kundër TNj në kuadër të SPB/QR për ÇK		MPB/Qendra e trajnimit - Idrizovë	2017-2018	Numri i trajnimeve të realizuara/Bashkëpunëtorë profesional të trajnuar	MPB
		8. Furnizimi me mjete materiale-teknike dhe pajisje informatike në pajtim me zyrtarët e sapo pranuar të policisë në NjTNjKM		MPB	2017-2018	Lloji dhe numri i mjeteve materiale-teknike dhe pajisjeve informatike të furnizuara	1. MPB 2. Donatorë/ON
Ngritja e kapaciteteve të MKR dhe QNPS/QPS	Është rritur efikasiteti i punës së MKR dhe QNPS/QPS. Në çdo QNPS/QPS janë shpërndarë punonjës social me përgjegjësi për punë me VTNj	9. Janë ngritur kapacitetet teknike dhe burimeve njerëzore të MKR dhe QNPS/QPS -Firmosja e marrëveshjeve/memorandumeve për bashkëpunim ndërmjet MPPS-MKR-SHQ që punojnë me VTNj në pjesën e ofrimit të ndihmës, përkrahjes, mbrojtjes dhe risocializimit		1. MPPS-MKR 2. SHQ	2017-2018	- Numri i punonjësve social me vendim pune që merren me VTNj - Specifikacion për pajisjet teknike të blera dhe shpërndara tek QPS - Numri i marrëveshjeve/memorandumeve të nënshkruara	1. MPPS-MKR 2. SHQ/ON



QËLLIMI STRATEGJIK	REZULTATI I PRITUR	AKTIVITETI		1. Institucioni kompetent, ON/SHQ - bartës i aktivitetit	KORNIZA KOHORE	TREGUESI	BUXHETI/BARTËS I BUXHETIT
				2. Institucioni, ON/SHQ-pjesëmarrës i aktivitetit			
Përkrahje financiare nga Qeveria e RM dedikuar SHQ që veprojnë në fushën e parandalimit, ndihmës, përkrahjes dhe mbrojtjes së VTNj	Është siguruar përkrahje financiare për SHQ që veprojnë në fushën e parandalimit, ndihmës, përkrahjes dhe mbrojtjes së VTNj	10. KK t'i dorëzojë informacion Qeverisë së RM për nevojën dhe përshtatshmërinë e përkrahjes financiare të SHQ që merren me TNj në fushën e parandalimit, mbrojtjes dhe përkrahjes së VTNj, në kuadër të Programit për përkrahje të sektorit qytetar		KK	2017-2020 një herë në vit	- Është dorëzuar informacioni tek Qeveria e RM	Qeveria e RM
		11. Plotësimi/përditësimi i kriterëve për zgjedhje të SHQ që mund të aplikojnë për të fituar grante në fushën e TNj, me qëllim arritjen e cilësisë së ofrimit të shërbimeve		MPPS-MKR/Sekretariati i përgjithshëm i Qeverisë së RM	2017	Kritere të përditësuara	Nuk ka
		12. Përkrahje financiare nga Qeveria e RM dedikuar SHQ që veprojnë në fushën e parandalimit, ndihmës, përkrahjes dhe mbrojtjes së VTNj		Qeveria e RM – Sekretariati i përgjithshëm	Një herë në vit 2017-2020	- Është shpallur thirrja nga Qeveria për financimin e së paku 4 SHQ - Janë zgjedhur së paku 4 SHQ dhe janë miratuar mjete financiare - Numri i granteve të akorduar dhe shuma e grantit	Qeveria e RM – Sekretariati i përgjithshëm
Funksionimi i plotë operativ i QPVTNj	Është caktuar buxhet vjetor nga MPPS-MKR dhe është mundësuar funksionim operativ i QPVTNj	13. Përpilimi i analizës për mjetet e nevojshme financiare në nivel vjetor për funksionimin e QPVTNj		MPPS-MKR	2017	- Është përgatitur analiza dhe është specifikuar buxheti në nivel vjetor	MPPS
		14. Është alokuar buxhet vjetor për funksionimin e QPVTNj		MPPS-MKR	2017-2020	Shuma e buxhetit për çdo vit	MPPS
	15. Gjetja e zgjidhjes adekuate dhe të qëndrueshme për financimin e partneritetit me SHQ për dhënie të shërbimeve tek QPVTNj		1. MPPS-MKR 2. SHQ	2017	Modeli i partneritetit publiko-privat në të cilin janë të përfshirë dhe SHQ	1. MPPS 2. SHQ	
	16. Rritja e numrit të punonjësve të trajnuar social në kuadër të QNPS Shkup, për shkak të mbulimit të plotë të VTNj në QPVTNj në pajtim me parimin 24 orë 7 ditë në javë	Janë forcuar kapacitetet e MPPS-MKR/QNPS Shkup në fushën e ofrimit të ndihmës, mbrojtjes dhe përkrahjes së VTNj në QPVTNj		MPPS-MKR/QNPS Shkup	2017-2020	Numri i punonjësve social të zgjedhur në QNPS Shkup	MPPS
	17. Trajnim për trajtimin e VTNj dedikuar punonjësve social të përzgjedhur që do të punojnë në QPVTNj		1. MPPS-MKR/QNPS Shkup 2. SHQ	2017-2018	Numri i trajnimeve të realizuara dhe profesionistëve të trajnuar	1. MPPS 2. SHQ/ON	
	Përfshirja aktive e SHQ-ve të përzgjedhur në ofrimin e ndihmës dhe përkrahjes psiko-sociale viktimave të TNj në QPVTNj	18. Formimi i ekipeve të përbashkëta të punonjësve sociale të QNPS në Qytetin e Shkupit me përfaqësues të SHQ për ofrimin e ndihmës dhe përkrahjes psiko-sociale viktimave të TNj vendosur në QPVTNj		1. MPPS/MKR/QNPS Shkup 2. SHQ	2017-2020	Numri i ekipeve të formuara të përbashkëta	MPPS-MKR/QNPS Shkup

QËLLIMI STRATEGJIK	REZULTATI I PRITUR	AKTIVITETI		1. Institucioni kompetent, ON/SHQ - bartës i aktivitetit	KORNIZA KOHORE	TREGUESI	BUXHETI/BARTËS I BUXHETIT
				2. Institucioni, ON/SHQ-pjesëmarrës i aktivitetit			
Përmirësimi i kapaciteteve dhe kushteve të Qendrës së Pranimi për të Huaj	Janë rritur kapacitetet, janë miratuar kushtet për strehimin e të huajve, grupeve të rrezikuara të të huajve, të miturve të huaj të pashoqëruar dhe familjeve	19. Rindërtimi i brendshëm i objektit aktual/Qendra e Pranimi për të Huaj, përmirësimi i kushteve të strehimit, ushqimi dhe higjiena		MPB	2017-2018	Janë rritur kapacitetet për strehim dhe janë përmirësuar kushtet për qëndrimin e të huajve	1. MPB 2. ON
		20. Përmirësimi i kapaciteteve njerëzore në fushën e sigurimit të ndihmës dhe përkrahjes psiko-sociale		MPB	2017-2020	Numri i punonjësve të shpërndarë për sigurimin e ndihmës dhe përkrahjes psiko-sociale	MPB
		21. Sigurimi i kushteve për përfshirjen e SHQ-ve profesionale që merren me problematikën e viktimave të trafikimit me njerëz dhe migrantëve në fushën e sigurimit të ndihmës dhe përkrahjes psiko-sociale		1. MPB 2. SHQ	2017-2020	Janë firmosur memorandume/numri i përfaqësuesve të përfshirë nga SHQ	1. MPB 2. SHQ
		22. Ndërtimi i një objekti të ri për pranimin dhe strehimin e të huajve me qëndrim të parregulluar në RM		MPB	2018-2020	Pranimi teknik i objektit të sapo ndërtuar	1. MPB 2. IPA II
Ngritja e kapaciteteve të Komisioneve Lokale për Luftimin e Trafikimit me Njerëz dhe Migrimit Ilegal (LTNjMI)	Përcaktimi i komunave në të cilat është e nevojshme formimi i Komisioneve Lokale për LTNjMI dhe formimi i komisioneve të reja për LTNjMI	23. Përpilimi i propozim buxhetit të nevojshëm për zbatimin e aktiviteteve të planifikuara në pajtim me PLV me KL në Manastir, Shtip, Gjevgjeli, Veles, Prilep dhe Tetovë për vitet 2017-2020		KL/Vetëqeverisja lokale	2018-2020	Buxheti i përgatitur/shuma e buxhetit në nivel vjetor	KL/Këshillat e vetëqeverisjeve lokale
		24. Përcaktimi i komunave në të cilat është e nevojshme formimi i Komisioneve Lokale për LTNjMI		KK	2017	Komunat e përcaktuara	Nuk ka
		25. Sjellja e vendimit të KK për formimin e KL për LTNjMI në komunat e përcaktuara		KK	2017-2018	Numri i aktit	Nuk ka
		26. Zgjedhje e anëtarëve të KL të formuara		1. KK/KL 2. SHQ/ON	2017-2018	Lista e anëtarëve të KL	Nuk ka
		27. Trajnimi i anëtarëve të KL për LTNjMI		1. KK/KL 2. SHQ/ON	2017-2018	Numri i trajnimeve të realizuara dhe numri i anëtarëve të trajnuar të KL	1. KK/KL 2. SHQ/ON

QËLLIMI STRATEGJIK	REZULTATI I PRITUR	AKTIVITETI		1. Institucioni kompetent, ON/SHQ - bartës i aktivitetit	KORNIZA KOHORE	TREGUESI	BUXHETI/BARTËS I BUXHETIT
				2. Institucioni, ON/SHQ-pjesëmarrës i aktivitetit			

**1.2.Struktura koordinuese:**

Forcimi i rolit koordinues i KK dhe transparencës së tij në realizimin e aktiviteteve	Është siguruar bashkërendim dhe ndërlidhje funksionale ndërmjet Komisionit Kombëtar, Sekretariatit, Nëngrupit për fëmijë dhe Komisioneve Lokale	28. Mbjtja e seancave çdo çerek vit e KK lidhur me aktivitetet për të cilat paraprakisht është prononcuar Sekretariati		KK	Në vazhdimësi ose së paku 4 herë në vit 2017-2020	Procesverbalet e seancave të mbajtura të KK/Sekretariatit/Nëngrupit për fëmijë	Nuk ka
		29. Koordinatorët e KL për LTNjMI ose përfaqësues i tij marrin pjesë në takimet e Komisionit Kombëtar ose Sekretariatit		KK/KL	Sipas nevojës 2017-2020	Procesverbal i seancave të mbajtura	Nuk ka
	Është siguruar efikasitet gjatë zbatimit të politikave	30. Komisioni Kombëtar, Komisionet Lokale dhe Nëngrupi për LTNj i fëmijëve, në nivel vjetor përpilojnë plane operative për zbatimin e PKV 2017-2020		KK/KL	2017-2020 Në nivel vjetor	Janë përpiluar dhe miratuar planet operative vjetore	Nuk ka
		31. Zgjerimi i anëtarësisë së KK dhe Sekretariatit		KK	2017	Akti për përfaqësues të emëruar nga: - Dhoma Ekonomike e RM, -Organizata e Punëdhënësve - Lidhja e Sindikatave e RM - Shoqata e Gazetarëve e RM	Nuk ka
		32. Komisioni Kombëtar themelon mekanizma për vlerësim dhe mbikëqyrje të planeve operative të zbatuara në nivel vjetor		KK	2017-2020	Analizë dhe raport mbi aktivitetet e zbatuara të parashikuara në planet operative	KK/RK
	Është siguruar transparencë në punën e Komisionit Kombëtar	33. Paraqitje publike e raportit vjetor të Komisionit Kombëtar dhe Raportuesit Kombëtar		KK/RK	Një herë në vit 2017-2020	Është mbajtur paraqitja vjetore publike e raportit vjetor	KK/RK
		34. Raportet vjetore të Komisionit Kombëtar dhe Raportuesit Kombëtar shpallen në faqen e internetit të KK në gjuhën maqedonase dhe angleze		KK/RK	2017-2020	Janë publikuar raportet vjetore	KK/RK
		35. Sigurimi i funksionalitetit/përditësimi i rregullt i faqes së internetit të KK		MPB	2017-2020	Kohë aktive e funksionalitetit të faqes së internetit	MPB

QËLLIMI STRATEGJIK	REZULTATI I PRITUR	AKTIVITETI		1. Institucioni kompetent, ON/SHQ - bartës i aktivitetit	KORNIZA KOHORE	TREGUESI	BUXHETI/BARTËS I BUXHETIT
				2. Institucioni, ON/SHQ-pjesëmarrës i aktivitetit			

**1.3 Korniza ligjore dhe rregullatore:**

Harmonizimi i legjislacionit kombëtar me atë ndërkombëtar	Legjislacioni kombëtar është harmonizuar plotësisht me legjislacionin ndërkombëtar në fushën e TNj dhe të drejtat e VTNj/migrantëve	36. Zbatimi i analizës për përcaktimin e harmonizimit të legjislacionit kombëtar me instrumentet juridike ndërkombëtare që kanë të bëjnë me të drejtat e VTNj/migrantëve		1. MeD 2. MPB/MPPS	2017	Është përgatitur analiza dhe janë përcaktuar dispozitat kombëtare që duhet të harmonizohen me normat juridike ndërkombëtare	1. MeD 2. MPB/MPPS
		37. Në bazë të analizës së realizuar, KK t'i dorëzojë ministrive kompetente një Iniciativë për propozim-ndryshime të ligjeve vijuese që duhet të jenë në harmoni me standartet ndërkombëtare: - Harmonizimi i dispozitave të Ligjit për të huaj që kanë të bëjnë me rregullimin e qëndrimit të përkohshëm të VTNj në pajtim me Konventën e Këshillit të Evropës - Kodin Penal të RM, në pajtim me dispozitat e Direktivës 2011/36/EK		1. KK 2. MPB	2017-2020	Iniciativat janë dorëzuar	Nuk ka
		38. Harmonizimi i Ligjit për mbrojtje sociale me ndryshimet e Ligjit për të huaj për strehimin e VTNj të huaj në QPVTNj - Ligji për prokurime publike, me futjen e dispozitave që do të sigurojnë mbrojtje nga eksploatimi i punës së VTNj gjatë realizimit të tenderëve		MPPS	2017-2020	Iniciativat janë dorëzuar	Nuk ka
	Ratifikimi i instrumenteve juridike ndërkombëtare	39. Realizimi i analizës para ratifikimit me qëllim harmonizimin me instrumentet juridike ndërkombëtare në vijim: - Konventën nr. 189 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës „Për punë të denjë të ndihmësve shtëpiak“, e cila shërben si një instrument i fuqishëm për parandalimin e trafikimit me njerëz me qëllim eksploatim pune, veçanërisht për punën e detyruar në kushte vendore		MPPS	2017-2020	Është përgatitur një propozim për fillimin e procedurës së ratifikimit të Konventës nr. 189 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës lidhur me punën e denjë të ndihmësve shtëpiak	Nuk ka
		40. „Konventa ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të të gjithë punëtorëve-migrantë dhe pjesëtarëve të familjeve të tyre“ e vitit 1990. Miratimi i kësaj konvente është jashtëzakonisht e rëndësishme nëse kihet parasysh fakti që Republika e Maqedonisë është vend transit i flukseve mikse migratore		MPPS	2017-2020	Është përgatitur propozim për fillimin e procedurës së ratifikimit të Konventës Ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të të gjithë punëtorëve-migrantë dhe pjesëtarëve të familjeve të tyre e vitit 1990	MPPS
		41. Fillimi i procedurës së ratifikimit të instrumenteve të cekura juridike ndërkombëtare		MPB/MPPS	2017-2020	Është përgatitur propozim-ligj për ratifikimin e konventave: Konventës nr. 189 „Për punë të denjë të ndihmësve shtëpiak“ dhe „Konventës ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të të gjithë punëtorëve-migrantë dhe pjesëtarëve të familjeve të tyre“	Nuk ka
